

Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve

Të ndërtojmë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët

Seri për botim

Këshilli i Evropës

Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve

*miratuar nga Komiteti i Ministrave
i Këshillit të Evropës
më 17 nëntor 2010
dhe memorandumit shpjegues*

Programi i Këshillit të Evropës
“Të ndërtojmë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët”

www.coe.int/children

Botimet e Këshillit të Evropës

Botimi në frëngjisht:

Lignes directrices du Comité des Ministres du Conseil de l'Europe sur une justice adaptée aux enfants

ISBN 978-92-871-7273-0

Riprodhimi i teksteve në këtë botim autorizohet me kusht që të citohet titulli i plotë dhe burimi, përkatësisht Këshilli i Evropës. Nëse synimi është që botimi të përdoret për arsye tregtare, ose nëse ai përkthehet në një ndër gjuhët jo zyrtare të Këshillit të Evropës, ju lutem kontaktoni publishing@coe.int.

Programi i Këshillit të Evropës “Të ndërtojmë Evropën me fëmijët dhe për fëmijët” është krijuar për të siguruar dhe për të promovuar të drejtat e njeriut të fëmijëve dhe për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës.

www.int/children

Kopertina dhe grafika: Departamenti i Dokumenteve dhe i Prodhimit të Botimeve (SPDP), Këshilli i Evropës

Ilustrimet: Eric Puybaret

Botimet e Këshillit të Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

<http://book.coe.int>

ISBN 978-92-871-7274-7

© Këshilli i Evropës, tetor 2011

Botuar në Këshillin e Evropës

Parathënie

Pjesa e parë

Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve

Preambula

- I. Objekti dhe qëllimi**
- II. Përkufizime**
- III. Parimet bazë**
 - A. Pjesëmarrja*
 - B. Interesat më të mira të fëmijëve*
 - C. Dinjiteti*
 - D. Mbrojtja nga diskriminimi*
 - E. Shteti i së drejtës*
- IV. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore**
 - A. Elementët e përgjithshëm të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve*
 1. Informimi dhe këshillimi
 2. Mbrojtja e jetës private dhe familjare
 3. Siguria (masat e posaçme mbrojtëse)
 4. Trajnimi i profesionistëve
 5. Qasja shumëdisiplinore
 6. Mohimi i lirisë
 - B. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara proceseve gjyqësore*
 - C. Fëmijët dhe policia*
 - D. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve gjatë proceseve gjyqësore*
 1. Aksesimi në gjykatë dhe në procesin gjyqësor
 2. Këshillimi dhe përfaqësimi ligjor
 3. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet

4. Shmangia e vonesave të panevojshme
5. Organizimi i proceseve gjyqësore, mjedisi miqësor ndaj fëmijëve dhe gjuha miqësore ndaj fëmijëve
6. Provat/dëshmitë e dhëna nga fëmijët

E. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore

V. Promovimi i masave të tjera miqësore ndaj fëmijëve

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

Pjesa e dytë

Memorandumi Shpjegues

Komente të përgjithshme

Pse duhet një instrument i ri?

Informacion bazë

Metoda e punës

Procesi i hartimit

Konsultimi me aktorët

Konsultimi me fëmijët dhe me të rinjtë

Struktura dhe përmbajtja

Hyrje

Memorandumi shpjegues

Preambula

I. Objekti dhe qëllimi

II. Përkufizime

III. Parimet bazë

A. Pjesëmarrja

B. Interesat më të mira të fëmijëve

C. Dinjiteti

D. Mbrojtja nga diskriminimi

E. Shteti i së drejtës

IV. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore

A. Elementët e përgjithshëm të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve

1. Informimi dhe këshillimi
2. Mbrojtja e jetës private dhe familjare
3. Siguria (masat e posaçme mbrojtëse)
4. Trajnimi i profesionistëve
5. Qasja shumëdisiplinore
6. Mohimi i lirisë

B. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara proceseve gjyqësore

C. Fëmijët dhe policia

D. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve gjatë proceseve gjyqësore

1. Aksesimi në gjykatë dhe në procesin gjyqësor
2. Këshillimi dhe përfaqësimi ligjor
3. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet
4. Shmangia e vonësive të panevojshme
5. Organizimi i proceseve gjyqësore, mjedisi miqësor ndaj fëmijëve dhe gjuha miqësore ndaj fëmijëve
6. Provat/dëshmitë e dhëna nga fëmijët

E. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore

V. Promovimi i masave të tjera miqësore ndaj fëmijëve

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

Mos ec përpara meje; mbase nuk të ndjek dot.
Mos ec prapa meje: mbase nuk të udhëheq dot.
Ec përkrah meje dhe ji miku im.

Kushtuar Albert Camus

Divorce, birësime, migracion, dhunë. Në ditët e sotme, çdo fëmijë ka të ngjarë të bjerë në kontakt me sistemin e drejtësisë në një mënyrë ose në një tjetër. Për shumë, kjo është eksperiencë shumë e pakëndshme, ndërkohë që mund të jetë ndryshe dhe duhet të jetë ndryshe dhe kur shumë pengesa dhe burime ankthi të panevojshëm mund të hiqen. Megjithëse në nivelet ndërkombëtare dhe evropiane janë përcaktuar me sukses parimet bazë, nuk mund të thuhet se drejtësia është gjithnjë miqësore me fëmijët dhe të rinjtë. Në përgjigje të drejtpërdrejtë të një konsultimi të gjerë të nxitur nga Këshilli i Evropës, fëmijët dhe të rinjtë raportuan për një mungesë të përgjithshme besimi tek sistemi i drejtësisë dhe nënvizuan shumë mangësi, të tilla si organizimi i brendshëm frikësues i institucioneve të drejtësisë, mungesa e informacionit dhe e shpjegimeve të përshtatshme për moshën e tyre, qasje e dobët ndaj familjes si dhe procese gjyqësore të cilat ose janë shumë të gjata ose, në të kundërt, janë shumë të përshpejtuara.

Këshilli i Evropës i ka miratuar udhëzimet për një drejtësi miqësore ndaj fëmijëve për të siguruar specifikisht që drejtësia të jetë gjithnjë miqësore ndaj fëmijëve, pavarësisht se kush janë apo çfarë bëjnë fëmijët. Duke marrë parasysh këtë gjë, një mik është dikush që të trajton mirë, dikush që të beson dhe dikujt të cilit ti mund t'i besosh, dikush i cili të dëgjon dhe të cilin ti e dëgjon, dikush i cili të kupton dhe të cilin ti e kupton. Një mik i vërtetë ka po ashtu guximin t'ua thotë kur jeni gabim dhe ju

qëndron pranë për t'ju ndihmuar për të gjetur një zgjidhje. Sistemi i drejtësisë miqësor ndaj fëmijëve duhet të përpiqet t'u përgjigjet këtyre idealeve.

Një sistem miqësor ndaj fëmijëve nuk "ecën" përpara fëmijëve, ai as nuk duhet t'i lërë ata pas

Ai i trajton fëmijët me dinjitet, respekt, kujdes dhe drejtësi. Ai është i aksesueshëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm. Ai i dëgjon fëmijët, i merr seriozisht pikëpamjet e tyre dhe siguron mbrojtjen dhe interesat e atyre të cilët nuk mund të shprehen (si, për shembull, foshnjat). Ai e përshtat ritmin e vet me atë të fëmijëve: ai nuk është as i shpejtë dhe as i tejzgatur, por ka ritëm të arsyeshëm. Udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve kanë për qëllim ta sigurojnë gjithë këto gjëra dhe të garantojnë që fëmijët kanë akses të përshtatshëm në drejtësi dhe që ata trajtohen me respekt dhe në mënyrë të denjë nga sistemi i drejtësisë.

Përzemërsia dhe miqësia ndaj fëmijëve ndihmojnë mbrojtjen e tyre

Intervista të përsëritura, organizime dhe procedura frikësuese, diskriminim: një mori praktikash të tilla e rrisin dhimbjen dhe traumën e fëmijëve të cilët mund të jenë paraprakisht në ankth të madh dhe në nevojë për mbrojtje. Një sistem miqësor ndaj fëmijëve sjell lehtësim dhe kompensim; ai nuk i shkakton dhimbje dhe vështirësi të mëtejshme fëmijëve dhe nuk i shkel të drejtat e tyre. Për më tepër, fëmijët nga lindja deri në moshën 17 vjeç, qofshin palë në proces gjyqësor, viktimë, dëshmitarë ose autorë veprash, duhet të përfitojnë nga qasja "fëmija vjen i pari". Udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve janë hartuar për t'ju ardhur në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve nga viktimizimi për herë të dytë nga sistemi i drejtësisë, dukshëm duke forcuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fëmijëve, mbështetur në metoda pune të harmonizuara shumëdisiplinore.

Nëse një sistemi miqësor ndaj fëmijëve nuk "ecën" përpara fëmijëve, ai nuk "ecën" as pas tyre

Evropa ka qenë dëshmitare e abuzimeve tragjike të drejtësisë ku pikëpamjeve të fëmijëve u janë dhënë peshë në përpjesëtim të zhdrejtë me cenimin e të drejtave të palëve të tjera, ose me cenim të interesave më të mira të fëmijëve. Në këto raste, më e mira është bërë armiku i së mirës. Siç deklarohet nga vetë fëmijët dhe të rinjtë, drejtësia miqësore ndaj fëmijëve nuk ka të bëjë me të qenit më shumë miqësore ose më shumë protektive seç duhet. Ajo nuk ka të bëjë as me të lënit e fëmijëve vetëm me barrën e marrjes së vendimeve në vend të të rriturve. Sistemi miqësor ndaj fëmijëve i mbron të rinjtë nga vështirësitë, siguron që ata zënë vendin që u takon dhe që atyre u dëgjohet zëri, i merr parasysh dhe i interpreton siç duhet fjalët e tyre pa vënë në rrezik besueshmërinë e drejtësisë, ose interesat më të mira të fëmijëve. Ai është i ndjeshëm ndaj moshës, përshtatet sipas nevojave të fëmijëve dhe garanton një qasje të individualizuar pa stigmatizimin ose etiketimin e fëmijëve. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve ka të bëjë me forcimin solid të një sistemi të përgjegjshëm, mbështetur në profesionalizëm dhe që garanton administrimin e mirë të drejtësisë dhe, në këtë mënyrë, frymëzon besim ndërmjet të gjithë palëve dhe aktorëve të përfshirë në proceset gjyqësore.

Një sistem drejtësie miqësor ndaj fëmijëve është në krah të fëmijëve duke u ofruar atyre ndihmë me anë të profesionistëve kompetentë

Sistemet e drejtësisë në të gjithë Evropën janë plot me politikëbërës dhe profesionistë kompetentë dhe dashamirës, të tillë si gjyqtarë, zyrtarë të institucioneve të zbatimit të ligjit, punonjës socialë dhe shëndetësorë, avokatë të të drejtave të fëmijëve, prindër dhe kujdestarë, të gatshëm të marrin dhe të këmbëjnë udhëzime për të zgjeruar punën e tyre të përditshme në interesin më të mirë të fëmijëve. Për shkak se ata qëndrojnë në pararojë të të drejtave të fëmijëve dhe se mund të sjellin një dallim domethënës për fëmijët përditë, përveç tekstit bazë të udhëzimeve, ky botim përmban një memorandum shpjegues ku jepen shembuj ose pjesë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe shembuj konkretë të praktikave të mira të frymëzuara nga dhe për profesionistët që punojnë me fëmijët në drejtësi.

Miratimi i udhëzimeve për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve është një hap domethënës përpara. Megjithatë, detyra do të jetë përmbushur vetëm atëherë kur ndryshimi të mund të shihet në praktikë. Për të arritur këtë gjë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të promovohen, shpërndahen dhe të monitorohen këto udhëzime dhe që ato të shërbejnë si bazë për politikëbërjen në nivelin kombëtar. Partnerët kyç ndërkombëtar, të tillë si Bashkimi Evropian dhe UNICEF-I, janë përfshirë në hapat e para për promovimin e udhëzimeve, ashtu siç edhe shumë aktorë kombëtarë dhe shoqëria civile, të cilët po konsolidojnë përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për udhëzimet ndërmjet aktorëve kryesorë.

Shpresoj që ky botim të inkurajojë dhe të lehtësojë detyrën e një qarku sa më të gjerë të mundshëm profesionistësh dhe politikëbërësish në nivelin kombëtar dhe në nivelet lokale, të cilët kanë përgjegjësinë e bërjes së sistemit të drejtësisë më miqësor ndaj fëmijëve.

Drejtësia duhet të jetë mikja e fëmijëve. Ajo nuk duhet të ecë përpara tyre, pasi fëmijët mund të mos jenë në gjendje ta ndjekin. Ajo nuk duhet të ecë prapa tyre, pasi fëmijët nuk duhet të ngarkohen me përgjegjësinë për të drejtuar. Ajo duhet të ecë vetëm thjesht krahas krahas me ta dhe të jetë mikja e tyre.

Të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës i kanë miratuar udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve si premtim për drejtësi dhe miqësi për çdo fëmijë. Tani ka ardhur koha të bëjnë të gjitha përpjekjet për ta përmbushur këtë premtim.

Maud de Boer Buquicchio
Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm
Këshilli i Evropës

Pjesa e parë

**Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të
Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve**

Udhëzime

(miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 17 nëntor 2010 në takimin e 1098-të të zëvendës ministrave)

Preambula

Komiteti i Ministrave,

Duke marrë parasysh se objektivi i Këshillit të Evropës është që të arrijë një unitet më të madh ndërmjet shteteve anëtare, në veçanti duke promovuar miratimin e rregullave të përbashkëta në çështjet ligjore;

Duke marrë parasysh nevojën e sigurimit të zbatimit efektiv të standardeve ekzistuese detyruese dhe të atyre evropiane të cilat mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë në veçanti:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara Lidhur me Statusin e Refugjatëve të vitit 1951;
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966;
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1966;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989;
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006;
- Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950, ETS Nr. 5) (më poshtë KEDNj);
- Konventën Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (1996, ETS Nr. 160);
- Kartën Sociale Evropiane të rishikuar (1996, ETS Nr. 163);

- Konventën e Këshillit të Evropës për Kontaktimin lidhur me Fëmijët (2003, ETS Nr. 192);
- Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (2007, CETS Nr. 201);
- Konventën Evropiane për Birësimin (e rishikuar) (2008, CETS Nr. 202);

Duke marrë parasysh se, siç garantohet nga KEDNj-ja dhe në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta e çdo personi për të pasur akses në drejtësi dhe në një proces të rregullt ligjor në të gjithë përbërësit e tij (përfshirë në veçanti të drejtën për t'u informuar, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për mbrojtje ligjore dhe të drejtën e përfaqësimit) është domosdoshmëri në një shoqëri demokratike dhe zbatohet njësoj edhe mbi fëmijët, megjithatë, duke marrë parasysh aftësinë e tyre për të pasur pikëpamjet vetjake;

Duke kujtuar jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, vendimet, raportet dhe dokumente të tjera të institucioneve dhe organeve të tjera të Këshillit të Evropës, përfshirë dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) dhe deklaratat dhe opinionet e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimet e ndryshme të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës;

Duke parë rekomandimet e ndryshme të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, përfshirë Rekomandimin Rec(2003)5 për masat e ndalimit të azilkërkuesve, Rekomandimin Rec(2003)20 lidhur me mënyrat e reja të trajtimit të kriminalitetit tek të miturit dhe rolin e drejtësisë për të miturit, Rekomandimin Rec(2005)5 për të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione rezidenciale, Rekomandimin Rec(2006)2 për Rregulloren Evropiane të Burgjeve, Rekomandimin CM/Rec(2008)11 për Rregulloren Evropiane për të miturit autorë veprash dhe objekt sanksionesh dhe masash dhe Rekomandimin CM/Rec(2009)10 për strategjitë kombëtare të integruara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;

Duke kujtuar Rezolutën Nr. 2 për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve, e miratuar në Konferencën e 28-të të Ministrave Evropianë të Drejtësisë (Lanzarote, tetor 2007);

Duke marrë parasysh rëndësinë e ruajtjes së të drejtave të fëmijëve nga instrumentet e Kombeve të Bashkuara, të tilla si:

- Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Bejxhingut, 1985);
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve që u është Mohuar Liria (Rregullat Havana, 1990);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit tek të Miturit (Udhëzimet e Rijadhit, 1990);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështje që Përfshijnë Fëmijë Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSOC Res 2005/20, 2005);
- Shënimi Udhëzues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara: Qasja e Kombeve të Bashkuara ndaj Drejtësisë për Fëmijët (2008);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Përdorimin dhe Kushtet e Përshtatshme të Kujdesit Alternativ për Fëmijët (2009);
- Parimet e lidhura me Statusin dhe Funkcionimin e Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut (Parimet e Parisit);

Duke kujtuar nevojën për të garantuar zbatimin efektiv të normave ekzistuese të detyrueshme lidhur me të drejtat e fëmijëve pa i penguar shtetet anëtare të prezantojnë ose të aplikojnë standarde më të larta, ose masa më të favorshme;

Duke ju referuar Programi të Këshillit të Evropës “Të ndërtojmë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët”;

Duke e njohur progresin e bërë në shtetet anëtare drejt zbatimit të një drejtësie miqësore ndaj fëmijëve;

Duke vënë re se, pavarësisht nga të gjitha këto, pengesat ekzistuese për fëmijët brenda sistemit të drejtësisë, të tilla si, ndërmjet të tjerash, të drejtat ligjore joekzistuese, të pjesshme ose të kushtëzuara për akses në drejtësi, larmia dhe kompleksiteti i procedurave, diskriminimi i mundshëm për shkaqe të ndryshme;

Duke nënvizuar nevojën për të parandaluar viktimizimin dytësor të fëmijëve nga sistemi gjyqësor në procedura që i përfshijnë ose i prekin fëmijët;

Duke i ftuar shtetet anëtare të analizojnë mangësitë dhe problemet ekzistuese dhe të identifikojnë fushat ku mund të prezantohen parimet dhe praktikatat e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve;

Duke i pranuar pikëpamjet dhe opinionet e fëmijëve të këshilluar në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës;

Duke vënë re që udhëzimet kanë për qëllim të kontribuojnë për identifikimin e mjeteve efektive praktike për të përmbushur mangësitë ekzistuese në fushën e së drejtës dhe në praktikë;

Miraton udhëzimet e mëposhtme për t'ju shërbyer shteteve anëtare për të përshtatur sistemet e tyre gjyqësore dhe jogjyqësore me të drejtat, interesat dhe nevojat specifike të fëmijëve, dhe i fton shtetet anëtare që t'i shpërndajnë gjerësisht këto udhëzime tek të gjitha autoritetet përgjegjëse për të drejtat e fëmijëve në drejtësi, ose të përfshira në mënyra të tjera në këto çështje.

I. Objekti dhe qëllimi

1. Udhëzimet trajtojnë çështjen e vendit dhe rolit, si dhe të pikëpamjeve, të drejtave dhe të nevojave të fëmijëve në proceset gjyqësore dhe në alternativat e këtyre proceseve;
2. Udhëzimet duhet të aplikohen për të gjitha mënyrat në të cilat fëmijët kanë të ngjarë të hyjnë në kontakt me të gjitha organet dhe shërbimet përgjegjëse

të përfshira në zbatimin e të drejtës penale, civile ose administrative, pavarësisht nga arsyeja dhe në çfarëdolloj kapaciteti.

3. Udhëzimet kanë për qëllim të sigurojnë respektimin e plotë të të drejtave të fëmijëve në procese të tilla, ndërmjet të cilave të drejtën për informim, të drejtën për përfaqësim, të drejtën për pjesëmarrje dhe të drejtën për mbrojtje, duke marrë parasysh nivelin e pjekurisë së fëmijës, nivelin e të kuptuarit prej tij/saj dhe rrethanat e çështjes. Respektimi i të drejtave të fëmijëve nuk duhet të cenojë të drejtat e palëve të tjera të përfshira.

II. Përkufizime

Për qëllime të këtyre udhëzimeve për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve (më poshtë “Udhëzimet”):

- a. “fëmija” është çdo person nën moshën 18 vjeç;
- b. “prindi” i referohet personit ose personave me përgjegjësi prindërore, mbështetur në të drejtën e brendshme. Në rast se prindi ose prindërit nuk janë të pranishëm për një periudhë të gjatë kohe, ose nuk i ushtrojnë më përgjegjësitë prindërore, prindi mund të jetë kujdestari ose një përfaqësues ligjor i emëruar;
- c. “drejtësia miqësore ndaj fëmijëve” i referohet sistemeve të drejtësisë të cilat garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të të gjithë fëmijëve në nivelin më të lartë të mundshëm, duke mbajtur parasysh parimet e përmendura më poshtë dhe duke i dhënë rëndësinë e nevojshme nivelit të pjekurisë dhe të kuptuarit së fëmijës dhe rrethanave të çështjes. Ajo është veçanërisht një drejtësi e aksesueshme, e përshtatshme për moshën, e shpejtë, e kujdesshme, e përshtatur për nevojat e fëmijëve dhe e përqendruar tek nevojat dhe të drejtat e tyre, e cila i respekton të drejtat e fëmijës përfshirë dhe të drejtat për proces të rregullt ligjor, për të marrë pjesë në proceset ligjore dhe për t’i kuptuar ato, për të respektuar të drejtën private dhe familjare dhe të drejtën për integritet dhe dinjitet.

III. Parimet bazë

1. Udhëzimet, të cilat janë mbështetur në parimet ekzistuese të mishëruara në instrumentet e përmendura në Preambulë dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
2. Këto parime janë zhvilluar më tej në seksionet e mëposhtme dhe aplikohen për të gjithë krerët e këtyre udhëzimeve.

A. Pjesëmarrja

1. Duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve për t'u informuar rreth të drejtave të tyre, për të pajisur me mjetet e nevojshme për të pasur akses në drejtësi dhe për t'u konsultuar dhe për t'u dëgjuar në proceset gjyqësore në të cilat ata janë të përfshirë, ose të cilat kanë ndikim mbi ta. Këtu përfshihet të dhënit e peshën së nevojshme pikëpamjeve të fëmijëve, duke marrë parasysh pjekurinë e tyre dhe vështirësitë që ata mund të kenë në komunikim për ta bërë të kuptimtë këtë pjesëmarrje.
2. Fëmijët duhet të konsiderohen dhe të trajtohen si zotërues të plotë të të drejtave dhe duhet të kenë të drejtë të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tyre në një mënyrë që merr parasysh kapacitetin e tyre për të formuar pikëpamjet e veta dhe rrethanat e çështjes.

B. Interesat më të mira të fëmijës

1. Shtetet anëtare duhet të garantojnë zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në mënyrë që interesat më të mira të tyre të përbëjnë aspektin parësor në të gjitha çështjet që i përfshijnë ose i prekin fëmijët.
2. Gjatë vlerësimit të interesave më të mira të fëmijëve të përfshirë ose të prekur:
 - a. pikëpamjeve dhe opinioneve të fëmijëve u duhet dhënë pasha e nevojshme;
 - b. të gjitha të drejtat e tjera të fëmijëve, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, duhet të respektohen gjatë të gjithë kohës;

- c. duhet të mishërohet një qasje përfshirëse nga të gjitha autoritetet përkatëse, në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat në diskutim, përfshirë dhe mirëqenien psikologjike dhe fizike, si dhe interesat ligjore, sociale dhe ekonomike të fëmijës.
3. Interesat më të mira të të gjithë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë ose çështje duhet të vlerësohen veçmas, të baraspeshohen me synimin e pajtimit të interesave konfliktuale të mundshme të fëmijëve.
 4. Ndërsa autoritetet gjyqësore kanë kompetencat dhe përgjegjësinë fundore për marrjen e vendimit përfundimtar, shtetet anëtare, kur është e mundur, mund të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të përcaktuar qasje shumëdisiplinore me synimin e vlerësimit të interesave më të mirë të fëmijëve në procedurat që i përfshijnë ata.

C. Dinjiteti

1. Fëmijët duhet të trajtohen me kujdes, ndjeshmëri, drejtësi dhe respekt përgjatë çdo procedure ose çështje, duke i kushtuar vëmendje të posaçme situatës së tyre personale, mirëqenies dhe nevojave specifike dhe duke respektuar integritetin e tyre fizik dhe psikologjik. Ky trajtim u duhet dhënë fëmijëve pavarësisht nga mënyra në të cilën ata kanë hyrë në kontakt me proceset gjyqësore ose jogjyqësore, ose me ndërhyrje të tjera dhe pavarësisht statusit të tyre ligjor ose zotësisë në çdo procedurë ose çështje.
2. Fëmijët nuk duhet të jenë objekt torture ose trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor ose degradues.

D. Mbrojtja nga diskriminimi

1. Të drejtat e fëmijëve sigurohen pa diskriminim për shkak të seksit, racës, ngjyrës ose prejardhjes etnike, moshës, gjuhës, fesë, opinionit politik ose ndonjë opinionit tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, prejardhjes social-ekonomike, statusit të prindit/prindërve, lidhjes me një pakicë kombëtare, pronës, lindjes, orientimit seksual, identitetit gjinor ose ndonjë statusi tjetër.

2. Fëmijëve më vulnerabël mund t'u duhet mbrojtje dhe ndihmë specifike, si për shembull, fëmijëve të migrantëve, fëmijëve të refugjatëve dhe të azilkërkuesve, fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të pastrehë dhe të rrugës, fëmijëve romë dhe fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale.

E. Shteti i së drejtës

1. Parimi i shtetit të së drejtës duhet të zbatohet plotësisht mbi fëmijët, ashtu sikurse zbatohet dhe mbi të rriturit.
2. Elementët e procesit të rregullt ligjor, të tilla si parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, prezumimi i pafajësisë, e drejta për proces të rregullt ligjor, e drejta për këshillim ligjor, e drejta për akses në gjykatë dhe e drejta për apelim u duhen garantuar fëmijëve ashtu siç i sigurohen dhe të rriturve dhe nuk duhen minimizuar ose mohuar me pretekstin e interesave më të mira të fëmijëve. Kjo qasje zbatohet për të gjitha proceset gjyqësore, jogjyqësore dhe administrative.
3. Fëmijët duhet të kenë të drejtën e aksesit në mekanizmat e duhur të pavarur dhe efektivë të ankimimit.

IV. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore

A. Elementët e përgjithshëm të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve

1. Informimi dhe këshillimi

Që prej përfshirjes së parë në sistemin e drejtësisë, ose me autoritete të tjera përgjegjëse (si për shembull me policinë, migracionin, shërbimet e kujdesit social ose shëndetësor) dhe përgjatë të gjithë këtij procesi, fëmijët dhe prindërit e tyre duhet të informohen menjëherë dhe siç duhet, *inter alia*, për:

- a. të drejtat e tyre, në veçanti për të drejtat specifike që kanë fëmijët lidhur me proceset gjyqësore dhe jogjyqësore ku ata janë të përfshirë ose ku mund të përfshihen dhe për instrumentet e disponueshme për ndreqjen e shkeljeve të mundshme të të drejtave të tyre, përfshirë dhe të drejtën për rekurs të një vendimi gjyqësor ose jogjyqësor, ose për ndërhyrje të tjera. Këtu

mund të përfshihet informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të proceseve, aksesit i mundshëm në mekanizmat e pavarur të apelit ose të ankesave;

- b. sistemin dhe procedurat e përfshira, duke marrë parasysh vendin e posaçëm që do të ketë fëmija dhe rolin që mund të luajë ai ose ajo në të dhe hapat e ndryshme procedurale;
 - c. mekanizmat ekzistues mbështetës për fëmijën kur ai merr pjesë në proceset gjyqësore ose jogjyqësore;
 - d. përshtatshmërinë ose pasojat e mundshme të proceseve të caktuara në gjykatë ose jashtë gjykate;
 - e. kur është e zbatueshme, për akuzat ose ndjekjen e ankesave të tyre;
 - f. kohën dhe vendin e proceseve të gjykatës dhe për aktivitetet e tjera përkatëse, të tilla si seancat dëgjimore, në rast se fëmija preket personalisht;
 - g. progresin e përgjithshëm dhe rezultatin e proceseve, ose të ndërhyrjes;
 - h. disponueshërinë e masave mbrojtëse;
 - i. mekanizmat ekzistues për analizimin e vendimeve që prekin fëmijën;
 - j. mundësitë ekzistuese për kompensim nga autori i veprës ose nga shteti nëpërmjet procesit të drejtësisë, nëpërmjet proceseve alternative civile, ose nëpërmjet proceseve të tjera;
 - k. disponueshmërinë e shërbimeve (shëndetësore, psikologjike, sociale, të interpretimit dhe përkthimit, etj.), ose për organizatat që mund të ofrojnë mbështetje dhe mjetet për të pasur akses në këto shërbime së bashku me mbështetjen financiare të emergjencave, kur është e zbatueshme.
 - l. çdo organizim të veçantë në dispozicion në mënyrë që të mbrohet interesi i tyre më i mirë sa më shumë të jetë e mundur nëse ata janë banues në një shtet tjetër.
2. Informacioni dhe këshillimi u duhen ofruar fëmijëve në një mënyrë që është e përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tyre, në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë dhe që është e ndjeshme në aspektin gjinor dhe kulturor.
 3. Si rregull, si fëmija dhe prindërit, apo përfaqësuesit ligjorë, duhet ta marrin informacionin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Dhënia e informacionit për prindërit nuk duhet të përbëjë alternativë për komunikimin e informacionit tek fëmija.

4. Për fëmijët duhet të vihen në dispozicion dhe të shpërndahen gjerësisht materiale miqësore ndaj fëmijëve, të cilat përmbajnë informacionin përkatës ligjor, si dhe shërbime të posaçme informimi, të tilla si faqet e specializuara të internetit dhe linja për t'ju ardhur në ndihmë atyre.
5. Informimi për çdo akuzë kundër fëmijës duhet të bëhet menjëherë dhe drejtpërdrejt pas ngritjes së akuzave. Ky informacion duhet t'i jepet si fëmijës dhe prindërve në mënyrë që ata të kuptojnë ekzaktësisht akuzën dhe pasojat e mundshme.
6. *Mbrojtja e jetës private dhe jetës familjare*

Privacia dhe të dhënat personale të fëmijëve të cilët janë aktualisht të përfshirë ose kanë qenë të përfshirë më parë në procese gjyqësore dhe jogjyqësore si dhe në ndërhyrje të tjera duhet të mbrohen në përputhje me të drejtën e brendshme. Në përgjithësi kjo nënkupton se informacionet ose të dhëna personale nuk mund të bëhen publike ose të botohen, veçanërisht në media, kur ato mund të nxjerrin në pah ose të mundësojnë në mënyrë të tërthortë bërjen me dije të identitetit të fëmijës, përfshirë imazhe, përshkrime të detajuara të fëmijës ose të familjes së fëmijës, emra ose adresa, regjistrime audio ose video, etj.
7. Shtetet anëtare duhet të parandalojnë shkeljet e të drejtave të privacisë, siç përmenden në Udhëzimin 6 më sipër, nga media nëpërmjet masave legislative, ose monitorimit të vetërregullimit nga media.
8. Shtetet anëtare duhet të parashikojnë akses të kufizuar në të gjitha dokumentet ose të dhënat që përmbajnë të dhëna personale dhe të ndjeshme të fëmijëve, në veçanti në proceset gjyqësore që i përfshijnë ata. Në rast se transferimi i të dhënave personale dhe të ndjeshme është i nevojshëm, ndërsa marrin parasysh interesin më të mirë të fëmijës, shtetet anëtare duhet ta rregullojnë këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave.
9. Kurdo që fëmijët dëgjohen ose japin prova në procese gjyqësore ose jogjyqësore, ose në ndërhyrje të tjera, kur është e mundur, preferohet që këto procese të mbahen me dyer të mbyllura. Si rregull, duhet të jenë të pranishëm

vetëm ata persona që janë drejtpërdrejt të përfshirë, me kusht që ata të mos i pengojnë fëmijët të japin prova.

10. Profesionistët që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët duhet të respektojnë rregullat strikte të konfidencialitetit, në përjashtim të rasteve kur ekziston rreziku i dëmtimit të fëmijës.

3. Siguria (masat e posaçme parandaluese)

11. Në të gjitha proceset gjyqësore dhe jogjyqësore, ose në masa të tjera ndërhyrëse, fëmijët duhet të mbrohen nga dëmtimi/cenimi, përfshirë kërcënimin, reprezaljet dhe një viktimizim tjetër.
12. Profesionistët që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët, kur është e nevojshme, duhet të jenë objekt i kontrollit të rregullt, sipas të drejtës së brendshme dhe pa cenuar pavarësinë e gjyqësorit, për të siguruar se ata janë të përshtatshëm për të punuar me fëmijët.
13. Në rastet kur autori i pretenduar i veprës është prindi, një anëtar i familjes ose një kujdestar parësor, mbi fëmijët duhet të përdoren masa të posaçme paraprake.

4. Trajnimi i profesionistëve

14. Të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët duhet t'i nënshtrohen trajnimit të nevojshëm ndërdisiplinor mbi të drejtat dhe nevojat e fëmijëve të grupeve të ndryshme moshore dhe për proceset e përshtatura për ta.
15. Profesionistët që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët duhet të trajnohen dhe për komunikimin me fëmijët e të gjitha moshave dhe fazave të zhvillimit dhe me fëmijët në situata të veçanta vulnerabiliteti.

5. Qasja dhumëdisiplinore

16. Duke respektuar plotësisht të drejtën e fëmijëve për jetë private dhe jetë familjare, duhet të inkurajohet bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet profesionistëve për të përfutur një kuptim të përgjithshëm të fëmijës dhe një

vlerësim të situatës së tij ose saj ligjore, psikologjike, sociale, emocionale, fizike dhe kognitive.

17. Për profesionistët që punojnë me fëmijët ose për fëmijët (të tillë si avokatët, psikologët, mjekët, policët, oficerët e migracionit, punonjësit socialë dhe ndërmjetësuesit) duhet të krijohet një kuadër i përbashkët vlerësimi në proceset gjyqësore ose ndërhyrjet që përfshijnë ose prekin fëmijët, për t'u dhënë atyre që marrin vendimet të gjithë mbështetjen e nevojshme, duke iu bërë atyre të mundur t'ju shërbejnë sa më mirë interesave të fëmijëve në një çështje të caktuar.
18. Teksa zbatohet një qasje shumëdisiplinore, duhet të respektohen rregullat profesionale për konfidencialitetin.

6. Mohimi i lirisë

19. Çdo formë e mohimit të lirisë për fëmijët duhet të jetë masë fundore dhe duhet të ushtrohet për periudhën më të shkurtër të nevojshme të kohës.
20. Kur vendoset mohimi i lirisë, si rregull, fëmijët duhet të mbahen veçmas nga të rriturit. Në rastet kur fëmijët mbahet i ndaluar bashkë me të rriturit, ndalimi duhet të bëhet për arsye përjashtimore dhe mbështetur vetëm në interesat më të mira të fëmijëve. Në të gjitha rrethanat, fëmijët duhet të ndalohen në ambiente që janë të përshtatshme për nevojat e tyre.
21. Për shkak të vulnerabilitetit të fëmijëve të cilëve u është mohuar liria, për shkak të lidhjeve familjare dhe duke promovuar riintegrimin e tyre në shoqëri, autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijës dhe të mbështesin aktivisht përmbushjen e të drejtave të fëmijës siç parashikohet në instrumentet universale dhe evropiane. Përveç të drejtave të tjera, fëmijët duhet të gëzojnë në veçanti të drejtën për:
 - a. mbajtjen e kontaktit të rregullt dhe të kuptimtë me prindërit, familjen dhe miqtë me anë të vizitave dhe korrespondencës, në përjashtim të rasteve kur kërkohen përjashtime në interes të drejtësisë dhe në interes të fëmijës. Kufizimet e kësaj të drejte nuk duhet të përdoren asnjëherë si ndëshkim;
 - b. marrjen e arsimit, udhëzimeve profesionale dhe trajnimit, kujdesit shëndetësor të përshtatshëm dhe për gëzimin e lirisë së mendimit,

- ndërgjegjes dhe fesë dhe për të pasur akses në aktivitete të kohës së lirë, përfshirë edukimin fizik dhe sportin;
- c. programe aksesit të cilat i përgatisin fëmijët paraprakisht për kthimin në komunitetet përkatëse, duke u kushtuar vëmendje të plotë lidhur me nevojat emocionale dhe fizike, marrëdhëniet familjare, strehimin, mundësitë për shkollim dhe punësim dhe statusin social-ekonomik.
22. Mohimi i lirisë për minorenët e pashoqëruar, përfshirë dhe ata që kërkojnë azil dhe fëmijët e ndarë nuk duhet të motivohet ose të mbështetet asnjëherë vetëm në statusin e vendbanimit.

B. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara proceseve gjyqësore

23. Moshën minimale të përgjegjësisë penale nuk duhet të jetë shumë e ulët dhe duhet të përcaktohet me ligj.
24. Alternativat ndaj proceseve gjyqësore, të tilla si ndërmjetësimi, ndryshimi (i mekanizmave gjyqësorë) dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve duhet të inkurajohen kurdo që ato i shërbejnë më mirë interesave më të mira të fëmijëve. Përdorimi paraprak i këtyre alternativave nuk duhet të përdoret si pengesë për aksesin në drejtësi të fëmijës.
25. Fëmijët duhet të informohen plotësisht dhe të konsultohen për mundësinë për rekurs ose në proceset e gjykatës ose në alternativat jashtë strukturave të gjykatave. Ky informacion duhet të përmbajë edhe shpjegimin për pasojat e mundshme të secilit opsion. Mbështetur në informacionin e nevojshëm, qoftë ligjor ose informacion tjetër, duhet të vihet në dispozicion përzgjedhja ose e procedurave gjyqësore, ose e alternativave ndaj këtyre procedurave kurdo që ato ekzistojnë. Fëmijëve u duhet dhënë mundësia të marrin këshillim ligjor dhe çdo ndihmë tjetër për përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së alternativave të propozuara. Në marrjen e këtij vendimi, duhet të merren parasysh pikëpamja e fëmijëve.
26. Alternativat ndaj proceseve të gjykatave duhet të garantojnë nivel ekuivalent të garancive ligjore. Respektimi i të drejtave të fëmijëve siç përshkruhet në këto udhëzime dhe në të gjithë instrumentët përkatës ligjorë për të drejtat e

fëmijëve duhet të garantohet në të njëjtin nivel si në proceset brenda gjykate edhe në proceset jashtë gjykate.

C. Fëmijët dhe policia

27. Policia duhet të respektojë të drejtat personale dhe dinjitetin e të gjithë fëmijëve dhe të mbajë parasysh vulnerabilitetin e tyre, pra, të marrë parasysh moshën dhe pjekurinë si dhe çdo nevojë të posaçme të fëmijëve që mund të jenë me paaftësi fizike ose mendore, ose që kanë vështirësi në komunikim.
28. Kurdo që një fëmijë kapet nga policia, fëmija duhet të informohet në një mënyrë dhe në një gjuhë që është e përshtatshme për moshën dhe nivelin e të kuptuarit të tij për arsyen se pse ai ose ajo është ndaluar nga policia. Fëmijëve duhet t'u sigurohet aksesit tek një avokat dhe duhet t'u jepet mundësia të kontaktojnë me prindërit ose me një person tjetër të cilit ata i besojnë.
29. Përveç rasteve përjashtimore, prindi (prindërit) duhet të informohet për praninë e fëmijës në rajonin e policisë, duke marrë detaje për arsyen pse është ndaluar fëmija dhe i kërkohet të vijë në rajon.
30. Një fëmijë i ndaluar nuk duhet të pyetet lidhur me sjelljen kriminale, ose nuk duhet t'i kërkohet të bëjë ose të nënshkruajë një deklaratë lidhur me këtë përfshirje, në përjashtim të rasteve kur është i pranishëm avokati ose prindërit e fëmijës, ose, nëse nuk i pranishëm asnjë prind, një person tjetër të cilit fëmija i beson. Prindi ose ky person mund të përjashtohet nëse dyshohen për përfshirje në sjelljen kriminale, ose nëse përfshihen në sjellje që çojnë në pengim të drejtësisë.
31. Policia duhet të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur që asnjë fëmijë të mos mbahet i ndaluar së bashku me të rriturit.
32. Autoritetet duhet të sigurohen se fëmijët e ndaluar nga policia mbahen në kushte të sigurta dhe të përshtatshme për nevojat e tyre.
33. Në shtetet anëtare ku kjo është pjesë e mandatit të tyre, prokurorët duhet të sigurojnë përdorimin e qasjeve miqësore ndaj fëmijëve përgjatë të gjithë procesit të hetimit.

D. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve gjatë proceseve gjyqësore

34. Si posedues të së drejtave, fëmijët duhet të kenë rekurs tek mjetet efektive për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtat e tyre, ose për të vepruar kundër shkeljeve të të drejtave të tyre. E drejta e brendshme duhet të lehtësojë, kur është e mundur, mundësinë e pasjes akses tek gjykatat për fëmijët që i kuptojnë mjaftueshëm të drejtat e tyre dhe përdorimin e mjeteve efektive ligjore për t'i mbrojtur këto të drejta mbështetur në këshillimin ligjor të dhënë në mënyrë të përshtatshëm.
35. Duhet të hiqet çdo pengesë për të pasur akses në gjykatë, të tilla si kostoja e proceseve gjyqësore ose mungesa e këshillimit ligjor.
36. Në raste të krimeve të caktuara specifike të kryera kundër fëmijëve, ose të aspekteve të caktuara të së drejtës civile ose familjare, aksesit në gjykatë duhet të jepet për një periudhë kohe pasi fëmija e ka kapur moshën e pjekurisë, kur është e nevojshme. Shtetet anëtare inkurajohen të rishikojnë periudhat e tyre të parashkrimit.

2. Avokati dhe përfaqësimi ligjor

37. Fëmijët duhet të kenë të drejtë të kenë avokatin dhe përfaqësimin e tyre ligjor, në emër të tyre, në procese gjyqësore ku ka ose mund të ketë një konflikt interesi ndërmjet fëmijës dhe prindërve ose palëve të tjera të përfshira.
38. Fëmijët duhet të kenë akses në ndihmën juridike falas, nën të njëjtat kushte si të rriturit, ose në kushteve më të lehta se të rriturit.
39. Avokatët që i përfaqësojnë fëmijët duhet të jenë trajnuar dhe të informuar për të drejtat e fëmijëve dhe për çështje të lidhura me to, të marrin trajnim vazhdues dhe të thelluar dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në nivelin e tyre të të kuptuarit.
40. Fëmijët duhet të konsiderohen si klientë me të drejta të plota, me të drejtat e tyre, dhe avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të shpalosin opinionin e fëmijës.
41. Avokatët duhet t'i japin fëmijës të gjithë informacionin dhe shpjegimet e nevojshme lidhur me pasojat e mundshme të pikëpamjeve dhe/ose opinionëve të fëmijës.

42. Në rastet kur ka interesa të kundërt ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, autoriteti përgjegjës ose duhet të caktojë një kujdestar *ad litem*, ose një përfaqësues tjetër të pavarur për të shpalosur pikëpamjet dhe interesat e fëmijës.
43. Duhet të garantohet përfaqësimi i përshtatshëm dhe e drejta për t'u përfaqësuar në mënyrë të pavarur nga prindërit, veçanërisht në proceset penale ku prindërit, anëtarët e familjeve ose kujdestarët janë autorët e pretenduar të veprës.

3. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamje

44. Gjyqtarët duhet të respektojnë të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar në të gjitha çështjet që i prekin ata, ose të paktën të sigurojnë dëgjimin e fëmijëve kur ata mendohet se i kuptojnë mjaftueshëm çështjet në diskutim. Mjetet që përdoren për këtë qëllim duhet t'i përshtaten nivelit të të kuptuarit të fëmijës, aftësisë së tij/saj për të komunikuar dhe duhet të marrin parasysh rrethanat e çështjes. Fëmijët duhet të konsultohen lidhur me mënyrën në të cilën ata duan të dëgohen.
45. Pikëpamjeve dhe opinionit të fëmijës i duhet dhënë pesha e nevojshme, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij/saj.
46. E drejta për t'u dëgjuar është e drejtë e fëmijës, jo detyrë e tij/saj.
47. Një fëmijë nuk duhet të përjashtohet nga e drejta për t'u dëgjuar vetëm për shkak të moshës. Kurdo që një fëmijë merr iniciativën për t'u dëgjuar në një çështje që e cenon atë, në përjashtim të rasteve kur është në interesin më të mirë të fëmijës, gjyqtari nuk duhet të refuzojë ta dëgjojë fëmijës dhe duhet të dëgjojë pikëpamjet dhe opinionet e tij/saj për gjëra që e prekin atë në çështjen nën shqyrtim.
48. Fëmijët duhet të pajisen me të gjithë informacionin e nevojshëm për mënyrën sesi të përdorin me efektivitet të drejtën për t'u dëgjuar. Megjithatë, atyre u duhet shpjeguar se e drejta për t'u dëgjuar dhe marrja parasysh e pikëpamjeve të tyre mund të mos përcaktojnë domosdoshmërisht vendimin përfundimtar.

49. Vendimet përfundimtare dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatave që kanë ndikim mbi fëmijët duhet të arsyetohen siç duhet dhe u duhen shpjeguar fëmijëve në një gjuhë të kuptueshme prej tyre, veçanërisht ato vendime në të cilat nuk janë reflektuar pikëpamjet dhe opinionet e fëmijëve.

4. Shmangia e vonesave të panevojshme

50. Në të gjitha proceset gjyqësore që përfshijnë fëmijët, duhet të zbatohet parimi i urgjencës për të dhënë një përgjigje të shpejtë dhe për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës, ndërsa respektohet sundimi i ligjit.

51. Në çështje të së drejtës familjare (për shembull, për marrjen e atësisë, kujdestarinë, rrëmbimin prindëror), gjykatat duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme shmangies së rreziqeve të pasojave negative mbi marrëdhëniet familjare.

52. Kur është e nevojshme, autoritetet gjyqësore duhet të marrin parasysh mundësinë e marrjes së vendimeve të përkohshme, ose të dhënies së vendimeve paraprake në mënyrë që ato të monitorohen për një periudhë të caktuar kohe në mënyrë dhe të rishikohen më vonë.

53. Në përputhje me të drejtën, autoritetet gjyqësore duhet të kenë mundësinë e marrjes së vendimeve që janë menjëherë të zbatueshme në rastet kur kjo do të ishte në interesin më të mirë të fëmijës.

5. Organizimi i proceseve gjyqësore, mjedisi miqësor ndaj fëmijëve dhe gjuha miqësore ndaj fëmijëve

54. Në të gjitha proceset gjyqësore fëmijët duhet të trajtohen me respekt për moshën, nevojat e posaçme, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit, dhe duke pasur parasysh çdo vështirësi që ata mund të hasin në komunikim. Çështjet ku përfshihen fëmijë duhet të trajtohen në ambiente jo kërcënuese dhe të ndjeshme ndaj tyre.

55. Përpara fillimit të proceseve gjyqësore, fëmijët duhet të njihen me strukturën/organizimin e gjykatës, ose të ndërtesave të tjera dhe me rolet dhe identitetet e zyrtarëve të përfshirë.

56. Duhet të përdoret një gjuhë që është e përshtatshme për moshën dhe nivelin e të kuptuarit të fëmijëve.
57. Kur fëmijët dëgjohen ose intervistohen në procese gjyqësore ose jogjyqësore dhe gjatë ndërhyrjeve të tjera, gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë duhet të ndërveprojnë me ta me respekt dhe ndershmëri.
58. Fëmijët duhet të lejohen të shoqërohen nga prindërit, ose, kur është e përshtatshme, një i rritur i përzgjedhur prej tyre, në përjashtim të rasteve kur është marrë një vendim i arsyetuar për të kundërtën lidhur me këtë person.
59. Metodatat e intervistimit, të tilla si regjistrimet në video ose në audio ose seancat paragjyqësore me dyer të mbyllura duhet të përdoren dhe të konsiderohen si prova të pranueshme.
60. Fëmijët duhet të mbrohen, për aq sa është e mundur, kundër imazhit ose informacionit që mund të jetë i dëmshëm për mirëqenien e tyre. Gjatë procesit të marrjes së vendimit për t'i bërë publike imazhe ose informacion që mund të jetë i dëmshëm për fëmijët, gjyqtari duhet të kërkojë këshilla nga profesionistët e tjerë, të tillë si psikologët ose punonjësit socialë.
61. Seancat gjyqësore që përfshijnë fëmijët duhet t'i përshtaten ritmit dhe kohëzgjatjes së vëmendjes tek fëmijët: duhet të planifikohen pushime të rregullta, ndërsa seancat nuk duhet të zgjasin shumë. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e fëmijëve me zotësi të plotë kognitive dhe për të mbështetur stabilitetin e tyre emocional, gjatë seancave gjyqësore ndërprerjet dhe gjërat që tërheqin vëmendjen duhet të mbahen në minimum.
62. Për aq kohë sa është e përshtatshme dhe e mundshme, dhomat e intervistimit dhe të pritjes duhet të organizohen në një mjedis miqësor për fëmijët.
63. Për aq sa është e mundur, duhet të krijohen gjykata të specializuara (ose kolegjet e gjykatave), procedura dhe institucione përkatëse për fëmijët që janë në konflikt me ligjin. Këtu mund të përfshihet krijimi i njësive të specializuara brenda policisë, gjyqësorit, sistemit të gjykatave dhe zyrës së prokurorisë.

6. Provat/deklaratat e dhëna nga fëmijët

64. Intervistat e dhëna nga fëmijët dhe mbledhja e deklaratave prej tyre, për sa të jetë e mundur, duhet të realizohen nga profesionistë të trajnuar. Duhet të

bëhet çdo përpjekje e mundshme që fëmijët t'i japin provat në ambientet më të favorshme të mundshme dhe mbështetur në kushtet më të përshtatshme të mundshme, duke pasur parasysh moshën, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit të tyre, si dhe çdo vështirësi komunikimi që ata mund të kenë.

65. Deklaratat audiovizive nga fëmijët të cilët janë viktima ose dëshmitarë duhet të inkurajohen, ndërsa respektohet e drejta e palëve të tjera për të kundërshtuar përmbajtjen e këtyre deklaratave.
66. Në rastet kur është e nevojshme më shumë sesa një intervistë, intervistat mundësisht duhet të realizohen nga i njëjti person për të siguruar koherencën e qasjes në interesin më të mirë të fëmijës.
67. Numri i intervistave duhet të jetë sa më i kufizuar të jetë e mundur dhe kohëzgjatja e tyre duhet të përshtatet me moshën dhe kohëzgjatjen e vëmendjes tek fëmija.
68. Kontakti i drejtpërdrejtë, konfrontimi ose ndërveprimi ndërmjet një fëmije viktimë ose dëshmitar me autorët e pretenduar të veprës duhet të shmanget, për sa më gjatë të jetë e mundur, në përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet nga fëmijë viktima.
69. Fëmijët duhet të kenë mundësi të japin prova për çështjet penale pa praninë e autorit të pretenduar të veprës.
70. Prania e rregullave më pak strikte për dhënien e provave, të tilla si mungesa e kërkesës për bërjen e betimit ose bërja e deklaratave të tilla të ngjashme, ose masa të tjera procedurale miqësore ndaj fëmijëve, në vetvete nuk duhet të zbehin vlerën që i jepet një dëshmie ose prove të dhënë nga fëmija.
71. Protokollet e intervistave të cilat marrin parasysh faza të ndryshme të zhvillimit të fëmijës duhet të projektohen dhe të zbatohen për të theksuar vlefshmërinë e provave të dhëna nga fëmija. Ato duhet të shmangin pyetjet orientuese dhe duhet të rrisin besueshmërinë.
72. Lidhur me interesat më të mira të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre, duhet të jetë e mundur për një gjyqtar t'i lejojë një fëmije të mos dëshmojë në gjykatë.
73. Deklaratat dhe provat e dhëna nga një fëmijë nuk duhet të prezumohen asnjëherë si të pavlefshme ose si jo të denja vetëm për shkak të moshës së fëmijës.

74. Duhet të shqyrtohet mundësia e marrjes së deklaratave të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë në ndërtesa posaçërisht të projektuara për të qenë miqësore ndaj fëmijëve dhe në një mjedis që është miqësor ndaj tyre.

E. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore

75. Avokati, kujdestari *ad litem* ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës duhet t'ia komunikojë dhe shpjegojë një vendim të caktuar fëmijës në një gjuhë të përshtatur sipas nivelit të të kuptuarit të fëmijës dhe duhet të japë informacionin e nevojshëm për masat e mundshme që mund të merren, të tilla si apelet ose mekanizmat e pavarur të ankimeve.

76. Autoritetet kombëtare duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të lehtësuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përfshijnë dhe prekin fëmijët pa vonesë.

77. Në rastet kur një vendim nuk është zbatuar, fëmijët duhet të informohen, mundësisht nëpërmjet avokatit, kujdestarit *ad litem* ose përfaqësuesit ligjor për mjetet në dispozicion ose me anë të mekanizmave jogjyqësore ose nëpërmjet aksesit në drejtësi.

78. Zbatimi i vendimeve gjyqësore me forcë duhet të jetë masë e burimit të fundit në çështjet familjare në të cilat përfshihen fëmijët.

79. Pas vendimeve në procese shumëkonfliktuale, duhet të ofrohet udhëzim dhe mbështetje, mundësisht pa pagesë, për fëmijët dhe familjet e tyre nga shërbime të specializuara.

80. Duhet të ofrohen programe ose masa të posaçme të kujdesit shëndetësor dhe të ndërhyrjes së përshtatshme sociale dhe terapeutike për viktimat e neglizhencës, dhunës, abuzimit ose të krimeve të tjera, mundësisht pa pagesë, ndërsa fëmijët dhe kujdestarët e tyre duhet të informohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme për disponueshmërinë e këtyre shërbimeve.

81. Avokati, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës duhet të ketë mandatin e marrjes së të gjitha hapave të nevojshëm, të kërkojë dëmshpërblim gjatë ose pas proceseve penale në të cilat fëmija ka qenë viktimë. Kur është e mundur, kostot mund të mbulohen nga shteti dhe më pas të paguhen nga autori i krimit.

82. Masat dhe sanksionet për fëmijët në konflikt me ligjin duhet të jenë gjithnjë konstruktive dhe përgjigje individuale ndaj akteve të kryera, duke mbajtur parasysh parimin e proporcionalitetit, moshën e fëmijës, mirëqenien fizike dhe mendore dhe zhvillimin dhe rrethanat e çështjes. Duhet të garantohet po ashtu e drejta për arsim, trajnim profesional, punësim, rehabilitim dhe riintegrim.
83. Për të promovuar riintegrimin brenda shoqërisë dhe në përputhje me të drejtën e brendshme, dosjet kriminale të fëmijëve nuk duhet të bëhen me dije jashtë sistemit të drejtësisë pas mbushjes së moshës madhore. Përjashtime nga bërja publike e këtij lloj informacioni mund të lejohen në raste të veprave të rënda, *inter alia*, për arsye të sigurisë publike ose kur bëhet fjalë për punësimin e fëmijëve.

V. Promovimi i masave të tjera miqësore ndaj fëmijët

Shtetet anëtare inkurajohen të:

- a. promovojnë kërkime në të gjitha aspektet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve, përfshirë teknikat e intervistimit që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve dhe shpërndarjen e informacionit dhe trajnimin për këto teknika;
- b. shkëmbejnë praktika dhe promovojnë bashkëpunimin në fushën e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve në nivelin ndërkombëtar;
- c. nxisin botimin dhe shpërndarjen më të gjerë të mundshme të versioneve të instrumenteve përkatëse ligjore që janë miqësore ndaj fëmijëve;
- d. krijojnë, ose mbajnë dhe përforcojnë, kur është e nevojshme, zyra informimi për të drejtat e fëmijëve, mundësisht të lidhura me shoqatat e avokatisë, shërbimet e mirëqenies, avokatin e popullit (të fëmijëve), organizatat joqeveritare (OJQ), etj.;
- e. lehtësojnë aksesin e fëmijëve në gjykata dhe në mekanizmat e ankimit dhe të njohin dhe të lehtësojnë më tej rolin e OJQ-ve dhe të organeve dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të tilla si avokati i popullit për fëmijët, për të mbështetur aksesin e fëmijëve në gjykata dhe në mekanizmat e pavarura të ankimit, si në nivelin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar;

- f. shqyrtojnë krijimin e një sistemi gjyqtarësh dhe avokatësh të specializuar për fëmijët dhe të zhvillojnë më tej gjykata ku mund të merren si masa ligjore dhe sociale në favor të fëmijëve dhe të familjeve të tyre;
- g. zhvillojnë dhe të lehtësojnë përdorimin nga fëmijët dhe nga të tjerët që veprojnë në emër të tyre të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave universale dhe evropiane të njeriut dhe të fëmijëve për sigurimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave kur nuk ekzistojnë mjetet e brendshme, ose kur ato janë shteruar;
- h. bëjnë të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e fëmijëve, një komponent të detyrueshëm në kurrikulat shkollore dhe për profesionistët që punojnë me fëmijët;
- i. zhvillojnë sistemet e mbështetjes që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e prindërve për të drejtat e fëmijëve;
- j. krijojnë qendra miqësore ndaj fëmijëve, ndërinstucionale dhe ndërdisiplinore për fëmijët viktime dhe dëshmitarë kur fëmijët mund të intervistohen dhe të ekzaminohen nga pikëpamja mjekësore për qëllime të mjekësisë ligjore, të vlerësohen në përgjithësi si dhe të marrin të gjitha shërbimet përkatëse terapeutike nga profesionistët përkatës;
- k. krijojnë mbështetje të specializuar dhe të aksesueshme dhe shërbime informacioni, të tilla si konsultime online, linja për t'ju ardhur në ndihmë fëmijëve dhe shërbime lokale të komunitetit pa pagesë;
- l. sigurohen që të gjithë profesionistët që punojnë në kontakt me fëmijët në sistemet e drejtësisë marrin mbështetjen dhe trajnimin e duhur, si dhe udhëzimet praktike për të garantuar dhe zbatuar siç duhet të drejtat e fëmijëve, në veçanti gjatë vlerësimit të interesave më të mirë të fëmijëve në të gjitha llojet e procedurave që i përfshijnë ose i prekin ata.

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

Shtetet anëtare inkurajohen po ashtu të:

- a. rishikojnë legjislacionin, politikat dhe praktikat e brendshëm për të siguruar reformat e nevojshme për të zbatuar këto udhëzime;

- b. ratifikojnë me shpejtësi, nëse nuk i kanë ratifikuar ende, konventat përkatëse të Këshillit të Evropës që lidhen me të drejtat e fëmijëve;
- c. rishikojnë dhe vlerësojnë në mënyrë periodike metodat e punës brenda strukturës miqësore ndaj fëmijëve;
- d. ruajnë ose të krijojnë një kuadër, duke përfshirë një ose më shumë mekanizma të pavarur, sipas rastit, për të promovuar dhe monitoruar zbatimin e këtyre udhëzimeve në përputhje me sistemet e tyre gjyqësore dhe administrative;
- e. sigurojnë që shoqëria civile, në veçanti organizatat, institucionet, ose organet që synojnë të promovojnë dhe të mbrojnë të drejtat e fëmijëve, marrin pjesë plotësisht në procesin e monitorimit.

Pjesa e Dytë

Memorandum Shpjegues

Pse një instrument i ri?

1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe nxitja e një drejtësie miqësore ndaj fëmijëve është përparësi për Këshillin e Evropës. Çështja e mbrojtjes së fëmijëve është trajtuar në Planin e Veprimit të Samitit të 3-të të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Evropës, organizuar në Varshavë në vitin 2005.
2. Ndërsa në nivelin ndërkombëtar, evropian dhe kombëtar ekzistojnë disa instrumente ligjore, ende ka mangësi si në fushën e së drejtës dhe në praktikë dhe qeveritë dhe profesionistët që punojnë me fëmijët kërkojnë udhëzime për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre standardeve. Në çështjet e njohura *V dhe T kundër Mbretërisë së Bashkuar* ku dy djem 10-vjeçar që kishin rrëmbyer dhe goditur për vdekje një 2-vjeçar u gjykuan si të rritur, nën një mbulim masiv nga media, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë “Gjykata”) konstatoi që gjykimi kishte qenë jo gjithëpërfshirës dhe kërcënues për fëmijët, të cilët nuk kishin qenë në gjendje të merrnin pjesë efektivisht në proceset gjyqësore kundër tyre dhe gjeti shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë “KEDNJ), i cili garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor. Në çështjen *Sahin k. Gjermanisë*, Gjykata konstatoi se shkelja themelore ishte mosdëgjimi i pikëpamjeve të vetë fëmijës dhe u shpreh se gjykata kombëtare duhet të merrte hapa të konsiderueshëm për të siguruar kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe se, vetëm nëpërmjet këtij instrumenti, mund të sigurohen interesat më të mire të fëmijës.
3. Këto çështje mund të ndodhnin thuajse në çdo shtet anëtar të Këshillit të Evropës. Ato ilustronë nevojën për zgjerimin e aksesit në drejtësi dhe për përmirësimin e trajtimit të fëmijëve në proceset gjyqësore dhe jogjyqësore,

rëndësinë e rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të profesionistëve që punojnë me fëmijët në këto procese dhe pajisjen e tyre me trajtim të përshtatur në mënyrë që të garantohen interesat më të mirë të fëmijëve dhe administrimi i mirë i drejtësisë.

Informacion bazë

4. Udhëzimet e mëposhtme përbëjnë përgjigjen e drejtpërdrejtë të Këshillit të Evropës ndaj Rezolutës Nr. 2 për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve, të miratuar në Konferencën e 28-të të Ministrave Evropianë të Drejtësisë (Lanzarote, 25-26 tetor 2007), ku kërkoheshin udhëzime konkrete për shtetet anëtare në këtë fushë. Për pasojë, Komiteti i Ministrave udhëzoi katër organe të Këshillit të Evropës për të përgatitur udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve (më poshtë “udhëzimet”), duke propozuar zgjidhje për t’ju ardhur në ndihmë shteteve anëtare për krijimin e sistemeve gjyqësore që i përgjigjen nevojave specifike të fëmijëve me synimin e sigurimit të aksesit efektiv dhe të përshtatshëm të fëmijëve në drejtësi dhe trajtimin efektiv nga drejtësia në çdo sferë, civile, administrative, ose penale.

Metoda e punës

5. Me këtë perspektivë të tërthortë në mendje, Këshilli i Evropës miratoi një qasje të integruar novatore duke mbledhur së bashku tre ndër komitetet e tij kryesore ndërqeveritare që merren me të drejtën civile dhe administrative (Komitetin Evropian për Bashkëpunim Ligjor – CDCJ), të drejtën penale (Komitetin Evropian për Problemet me Krimin – CDPC) dhe Komisionin Evropian për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ). Udhëzimet u hartuan po ashtu në bashkëpunim të ngushtë me programin “Të ndërtojnë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët”, i cili e bëri drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve një ndër shtyllat kryesore të Strategjisë 2009-11 së Këshillit të Evropës për të drejtat fëmijëve.

6. Këshilli i Evropës e filloi këtë punë në vitin 2008 me përgatitjen e katër raporteve të ekspertëve që vlerësonin sfidat dhe pengesat me të cilat haseshin fëmijët për të siguruar akses në drejtësi në nivelin kombëtar në të gjithë sektorët e sistemit gjyqësor. Këto raporte janë paraqitur dhe përdorur si bazë për diskutimet në konferenca të nivelit të lartë të Këshillit të Evropës, të organizuara nën drejtimin e kryesisë suedeze të Komitetit të Ministrave “Të ndërtojmë Evropën me fëmijët dhe për fëmijët – drejt një strategjie për 2009-11-ën” (Stokholm, 8-10 shtator 2008), dhe kryesisë spanjolle të Komitetit të Ministrave “Mbrojtja e fëmijëve në sistemet evropiane të drejtësisë” (Toledo, 12-13 mars 2009). Gjetjet e raportit dhe përfundimet e konferencave shtruan rrugën për hartimin e udhëzimeve dhe ofruan material të vyer për Grupin e Specialistëve për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve (CJ-S-CH), i cili u krijua për të hartuar udhëzimet 2009-10.

Procesi i hartimit

7. Grupi i Specialistëve, i përbërë nga 17 specialistë të pavarur, u përzgjedh nga Këshilli i Evropës në konsultim me CDCJ-në, CDPC-në dhe CDDH-në, mbështetur në eksperiencën e tyre personale në fushën e të drejtave të fëmijëve, ndërsa u respektua një balancë specializimi (ndërmjet të drejtës civile dhe administrative, të drejtës penale dhe të drejtave të njeriut) si dhe një balance gjeografike dhe gjinore. Grupi kishte Z. Seamus Carroll (Irlandë), Kryetari i CDCJ-së, si kryetar, Znj. Ksenija Turdovic (Kroaci), e emëruar nga CDPC-ja, si zëvendëskryetare dhe Znj. Ankie Vandekerckhove, specialiste e të drejtave të fëmijëve nga Belgjika, si eksperte shkencore.
8. Grupi përfshinte gjyqtarë, avokatë, prokurorë, akademikë, psikologë, oficerë policie, punonjës socialë dhe përfaqësues nga qeveritë e shteteve anëtare dhe, për pasojë, karakterizohej nga një përbërje shumëdisiplinore. Në këtë punë kanë kontribuar dhe shumë vëzhgues, përfshirë dhe përfaqësuesit e organizatave kryesore ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare.

9. Projektudhëzimet dhe memorandumit i tyre shpjegues u shqyrtuan dhe miratuan nga CDCJ-ja gjatë takimit të 85-të plenar, organizuar nga data 11 deri më 14 tetor 2010, përpara se t'i dërgoheshin për miratim Komitetit të Ministrave më 17 nëntor 2010. Përpara kësaj, CDPC-ja dhe CDDH-ja e prezantuan tekstin dhe e mbrojtën atë në seancat përkatëse plenare (të organizuara përkatësisht më 7-10 qershor dhe 15-18 qershor 2010).

Konsultimet me aktorët

10. Konsultimi i aktorëve të ndryshëm për projektudhëzimet është realizuar përgjatë të gjithë procesit të hartimit nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme publike për versionet përkatëse të projektdokumentit nga tetori i vitit 2009 deri në maj të vitit 2010. Më 7 dhjetor 2009 u organizuar në Strasburg një seancë dëgjimore me OJQ dhe me aktorë të tjerë të specializuar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Drafti i katërt i udhëzimeve iu dërgua shteteve anëtare dhe specifikisht pikave të kontaktit për komente, si dhe disa partnerëve të jashtëm në periudhën nga janari deri në maj të vitit 2010. Komentet u morën më pas pasqyruar nga grupi kur u përfundua teksti, duke siguruar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës miratimi.

Konsultimi me fëmijët dhe me të rinjtë

11. Në përputhje me termat e referencës të këtij Grupi Specialistësh, Këshilli i Evropës ka organizuar po ashtu një konsultim të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe me të rinjtë për temën e drejtësisë në vitin 2010. Në këtë konsultim kontribuan rreth 30 partnerë në të gjithë Evropën, duke hartuar, përkthyer dhe shpërndarë një pyetësor në 11 gjuhë dhe duke organizuar grupe të fokusuara. Janë analizuar ekzaktesisht 3 721 përgjigje nga 25 shtete nga Dr. Ursula Kilkelly, eksperte irlandeze për të drejtat e fëmijëve, të cilat u morën pasqyruar nga CJ-S-CH-ja në përfundimin e udhëzimeve. Temat përfshinin familjen, (keq)besimin e

kompetencave, nevojën për respekt dhe rëndësinë e të dëgjuarit për fëmijët dhe të rinjtë.¹

12. Ky konsultim është përpjekja e parë e Këshillit të Evropës për të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë fëmijët dhe të rinjtë gjatë hartimit të një instrumenti ligjor dhe do të shtrihet në aktivitete të ngjashme të mëvonshme me synimin e sigurimit të pjesëmarrjes të kuptimtë të fëmijëve dhe të rinjve në punën normative të organizatës. Ai u realizua me mbështetjen bujare financiare të Qeverisë së Finlandës.

13. Gjatë procesit të hartimit janë bërë ndryshime të shumta për të siguruar që udhëzimet i plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe për t'ju përgjigjur tregimeve të fëmijëve për sistemin e drejtësisë. Në përgjithësi u bë një përpjekje e vërtetë për të siguruar marrjen parasysh të këtyre pikëpamjeve në detajet, objektin dhe përmbajtjen e gjerë të udhëzimeve.

14. Në veçanti, pikëpamjet e fëmijëve janë përdorur për të:

- mbështetur shkallën dhe mënyrën në të cilën udhëzimet e njohin të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar, për të marrë informacion rreth të drejtave të tyre, për të gëzuar përfaqësimin e pavarur dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive në vendimet e marra për ta. Formulimi në të gjitha seksionet përkatëse është forcuar në këto aspekte. Për shembull, udhëzimet tani u kërkojnë gjyqtarëve të respektojnë të drejta e të gjithë fëmijëve për t'u dëgjuar në të gjitha çështjet që i prekin ata dhe kërkojnë që mjetet e përdorura të përshtaten sipas nivelit të të kuptuarit të fëmijëve dhe aftësisë së tyre për të komunikuar dhe për të marrë parasysh rrethanat e çështjes;

¹ Raporti mund të gjendet në faqen e internetit të Këshillit të Evropës në adresën www.int/childjustice.

- siguruar ofrimin e formulimit të përshtatshëm në udhëzime për fëmijët për të kuptuar dhe për të marrë informacion për peshën që u është dhënë pikëpamjeve të tyre;
- forcuar parashikimin në udhëzime për mbështetjen për fëmijët përpara, gjatë, dhe pas kontaktit me sistemin e drejtësisë. Rëndësi e posaçme i është dhënë rolit të prindërve dhe të atyre të cilëve u besohen fëmijët (për shembull, seksioni për fëmijët dhe policinë);
- mbështetur dispozitat për një të drejtë të patjetërsueshme për aksesin në mekanizmat e pavarur dhe efektivë të ankimimit për të gjitha palët e sistemit të drejtësisë, për të mbështetur specializimin ndërmjet profesionistëve dhe kërkimin e trajnimit të nevojshëm për të gjithë profesionistët të cilët bien në kontakt me fëmijët në sistemin e drejtësisë. Këto çështje janë konsideruar themelore për trajtimin e mungesës së besimit tek autoritete, siç është shprehur nga fëmijët gjatë konsultimeve;
- forcuar dispozitën lidhur me konfidencialitetin e profesionistëve që merren me fëmijët;
- nxitur konsultimet dhe partneritetin me fëmijët, sipas nevojës, lidhur me funksionimin e sistemeve të drejtësisë së fëmijëve dhe zhvillimin dhe rishikimin e ligjeve, politikave dhe praktikave.

Struktura dhe përmbajtja

15. Udhëzimet janë dokument jo i detyrueshëm. Ndërsa në udhëzime përdoret shpesh fjala “duhet” atëherë kur parimet përkatëse janë marrë nga një dokument ligjor i detyrueshëm, që mund të jetë një instrument i Këshillit të Evropës, ose një instrument tjetër ndërkombëtar, përdorimi i fjalës “duhet” nuk duhet të kuptohet si ulje e efektit ligjor të instrumentit të detyrueshëm.
16. Udhëzimet mbështeten në standardet ekzistuese ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare. Interesat më të mirë të fëmijëve janë drejtimit udhëzuese,

pasi ato marrin parasysh parimet bazë të parashikuara në KEDNJ dhe në jurisprudencën përkatëse të Gjykatës dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Udhëzimet promovojnë dhe mbrojnë, ndërmjet të tjerash, të drejtën për informim, përfaqësim dhe pjesëmarrje të fëmijëve në proceset gjyqësore dhe jogjyqësore dhe i japin vend dhe zë fëmijës në drejtësi në të gjitha fazat e procedurave. Si instrument praktik, ato përfaqësojnë po ashtu praktika të mira dhe propozojnë zgjidhje praktike për të ndrequr papërputhshmëritë dhe boshllëqet ligjore. Për shembull, trajtohen teknikat e posaçmet për të dëgjuar një fëmijë (përfshirë dhe mjedisin e një gjykate). Udhëzimet nuk përfshijnë vetëm deklarinimin e parimeve, por aspirojnë të jenë një udhërrëfyes praktik për zbatimin e çuarjen përpara të standardeve të rena dakord në nivelin ndërkombëtar dhe të detyrueshme.

17. Në përputhje me termat e referencave të CJ-S-CH-së, teksti i udhëzimeve është strukturuar rreth parimeve të ndryshme të zbatueshme më parë, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore.

18. Vëmendja shteteve anëtare që po shqyrtojnë mundësinë e hartimit të legjislacionit lidhur me fëmijët në proceset gjyqësore dhe jogjyqësore është tërhequr tek parimet, standardet dhe praktikat e mira të njohura të udhëzimeve².

² Informacion rreth punës së Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve dhe progresin e saj mund të gjendet në faqen e internetit www.coe.int/childjustice.

Hyrje

19. Gjatë dekadave të fundit, shumë organizata publike dhe private, avokatë të popullit, politikëbërës dhe të tjerë janë përpjekur të sigurojnë që fëmijët³ të bëhen të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe që këto të drejta të përforcohen në jetët e tyre të përditshme. Ndërsa kohët e fundit kemi festuar 60 vjetorin e KEDNJ-së dhe 20 vjetorin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, realiteti në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dëshmon shpesh se të drejtat e fëmijëve dhunohen ende.
20. Fëmijët mund të bien në kontakt me procese gjyqësore dhe jogjyqësore në shumë mënyra, si për shembull, kur prindërit e tyre ndahen ose luftojnë për të marrë kujdestarinë e fëmijëve, kur kryejnë krime, janë dëshmitarë të krimeve ose viktima të krimeve, kërkojnë azil, etj. Fëmijët janë posedues të së drejtave dhe në këtë kuadër është e nevojshme që procedurat të bëhen më miqësore ndaj fëmijëve në mënyrë që ata të mbështeten në mënyrën më të mirë të mundshme tek to në rast se do t'u duhet të përfshihen në procese gjyqësore ose jogjyqësore për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre⁴.
21. Për fëmijët ekzistojnë shumë pengesa ligjore, sociale, kulturore dhe ekonomike për të pasur akses në gjykata, ku mungesa e zotësisë juridike është mbase pengesa më e rëndësishme. Shpesh fëmijët përfaqësohen nga prindërit ose nga kujdestarët e tyre. Por, kur përfaqësuesi ligjor nuk dëshiron të veprojë në emër të tyre, ose e ka të pamundur ta bëjë këtë gjë, ose kur organet përgjegjëse nuk e nisin një procedure, shpesh fëmijët nuk kanë një mënyrë që

³ Personat deri në moshën 18 vjeç.

⁴ U. Kilkelly, "Gjykatat për të rinjtë dhe të drejtat e fëmijëve: eksperiencia irlandeze", në *Drejtësia për të Rinjtë* f. 41: "Konventa për të drejtat e fëmijëve, e miratuar në vitin 1989, e forcoi këtë mbrojtje duke ofruar një gamë standardesh të procesit të rregullt që njohën të drejtën e fëmijëve për proces të rregullt ligjor, por shkuan më tej për njohjen e nevojës për ta përshtatur procesin e gjykimit me nevojat dhe të drejtat e fëmijëve."

të mbrojnë të drejtat e tyre, ose të veprojnë kundër shkeljeve. Në këto raste dhe nëse nuk është emëruar një përfaqësues i posaçëm nga autoriteti përgjegjës, fëmijët nuk mund të gëzojnë të drejtën bazë për ta çuar një çështje në gjykatë, megjithëse KEDNJ-ja përmban disa parime bazë me këtë efekt (shih Nenin 6, i cili përfshin, *inter alia*, të drejtën për proces të rregullt ligjor). Dhe, ndërsa Konventa përfshin të drejtat e njeriut për “këdo”, dërgimi i një çështjeje në gjykatë është shumë i vështirë për fëmijët. Pavarësisht faktit që gjykata ka ca jurisprudencë të zhvilluar lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve, gjykatat, si ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare, rrallë janë të aksesueshme nga fëmijët ndërsa të rriturit janë kryesisht ata të cilët nisin procese në emër të fëmijëve⁵. Për pasojë, aksesit i fëmijëve në drejtësi duhet të trajtohet në udhëzimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve⁶.

22. Udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve kanë për qëllim të trajtojnë statusin dhe pozicionin e fëmijëve dhe mënyrën në të cilën ata trajtohen në proceset gjyqësore dhe jogjyqësore. Megjithatë, përpara çuarjes së çështjeve në gjykatë, mund të jetë në interesin më të mirë të fëmijëve që ata t'i drejtohen metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të tilla si ndërmjetësimi. Këto udhëzime përfshijnë proceset si brenda dhe jashtë gjykatës.

23. Ato kanë për qëllim të nxisin diskutimet lidhur me të drejtat e fëmijëve në praktikë dhe i inkurajojnë shtetet anëtare të marrin hapa të mëtejshme për t'i kthyer ato në realitet dhe për të mbushur hendekun ekzistues. Ato nuk janë hartuar për të pasur ndikim mbi të drejtën substantive ose të drejtat substantive të fëmijëve, dhe as nuk kanë natyrë të detyrueshme ligjore. Pjesa më e madhe e udhëzimeve kërkojnë vetëm një ndryshim në qasje gjatë trajtimit të pikëpamjeve dhe nevojave të fëmijëve.

⁵ F. Tuken, “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe të drejtat e fëmijëve”, Drejtësia Ndërkombëtare për Fëmijët, Monografi Nr. 3, Botimet e Këshillit të Evropës, 2009, f. 17-33.

⁶ Kjo është edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh që termat e referencës së Grupit të Ekspertëve për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve përfshijnë dhe identifikimin e mangësive në këto çështje.

24. Ato kanë po ashtu si qëllim të shërbejnë si mjete praktike për shtetet anëtare për përshtatjen e sistemeve të tyre gjyqësore dhe jogjyqësore ndaj nevojave specifike të fëmijëve në procedurat penale, administrative dhe të drejtësisë civile, pavarësisht nga statusi ose kapaciteti i tyre. Ato duhet të përdoren po ashtu në fusha shumë specifike të së drejtës, të tilla si legjislacioni për mbrojtjen e të rinjve që ekziston në shumë shtete anëtare.
25. Në këtë kontekst, udhëzimet kërkojnë të lehtësojnë zbatimin e parimeve udhëzuese të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Po ashtu, të gjitha të drejtat e parashikuara nga KEDNJ-ja dhe të konfirmuara nga Gjykata do të zbatohen njësoj për fëmijët ashtu si edhe për të rriturit.
26. Për shkak se mangësitë ndërmjet këtyre dispozitave dhe të drejtave aktuale të fëmijëve janë të mëdha, në memorandumun shpjegues jepen referenca të shpeshta tek praktikat e mira, qofshin ato faktike ose ligjore, të hasura në shtetet anëtare dhe në jurisprudencë. Ato mund të shërbejnë si informacion i dobishëm dhe si frymëzim.

Memorandum shpjegues

Preambula

27. Organizatat kryesore ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut, të tilla si Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, kanë zhvilluar standarde dhe udhëzime të rëndësishme për të drejtat e fëmijëve. Ato do të shqyrtohen në vendin e duhur. Në preambulë përmenden ato standarde të cilat janë posaçërisht të rëndësishme në këtë fushë pa i ndaluar shtetet anëtare nga prezantimi ose zbatimi i standardeve më të larta ose i masave më të favorshme. Ajo u bën thirrje po ashtu shteteve anëtare të ratifikojnë me shpejtësi konventat e Këshillit të Evropës lidhur me të drejtat e fëmijëve. Kjo është masë praktike pasi shumë nga këto instrumente nuk janë ratifikuar nga një numër i madh shtetesh⁷.

I. Objekti dhe qëllimi

28. Objekti dhe qëllimi i instrumentit trajtohen nga paragrafi 1 deri në paragrafin 3. Siç është theksuar dhe më parë, udhëzimet zbatohen për të drejtën penale, civile ose administrative dhe synojnë respektimin e plotë të të gjitha të drejtave të fëmijëve në procese të tilla, ndërsa gjendet balanca e duhur me të drejtat e palëve të tjera të përfshira në procese.

II. Përkufizime

29. Përkufizimi i “fëmijës” është formuluar në përputhje me nenin 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe nenin 1.1 të Konventës Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (ETS nr. 160). KEDNJ-ja

⁷ Dokument i PACE-s (AS/Jur (2009)40) “Specifikat dhe vlera e shtuar e *acquis*-it të së drejtës së traktatit të Këshillit të Evropës.

garanton të drejtat e “kujtudo” dhe nuk i përjashton të drejtat e personave nën moshën 18 vjeç. Mund të ketë raste kur një individ nën moshën 18 vjeç nuk konsiderohet fëmijë, për shembull, në rastet e emancipimit, siç është rasti në disa shtete anëtare.

30. Përkufizimi i “prindit” në paragrafin b përfshin të gjithë personat me përgjegjësi prindërore, të cilët jo gjithmonë mund të jenë prindërit biologjikë, por edhe persona të tjerë që mbartin përgjegjësi prindërore, të tillë si kujdestarët ose përfaqësuesit ligjor të caktuar nga organet përgjegjëse.

31. Ndërsa drejtësia “miqësore ndaj fëmijëve” është përkufizuar në paragrafin c, teksti qartëson po ashtu se objekti është më i gjerë sesa sistemi aktual i drejtësisë dhe sesa seancat aktuale gjyqësore. Ai u drejtohet të gjithë profesionistëve që merren me fëmijët brenda dhe jashtë proceseve gjyqësore. Sektorë të tillë si policia, shërbimet e kujdesit social dhe të kujdesit shëndetësor janë po ashtu përgjegjës për bërjen e drejtësisë më miqësore ndaj fëmijëve. Udhëzimet synojnë të sigurojnë njohjen dhe respektimin skrupuloz të të drejtave të fëmijëve nga të gjithë profesionistët.

III. Parimet themelore

A. Pjesëmarrja⁸

⁸ Për më shumë informacion shihni Komentin e Përgjithshëm n r. 12 për të drejtën e fëmijëve për t’u dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009) dhe komentet në pikën IV, D, 3, e drejta për t’u dëgjuar. Shihni po ashtu Rekomandimin nr. R (98) 8 e Komitetit të Ministrave për pjesëmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe sociale, 18 shtator 1998, paragrafi 4: “pjesëmarrja e fëmijëve është faktor vendimtar për sigurimin e kohezionit social dhe për të jetuar në demokraci, në përputhje me vlerat e një shoqërie multikulturore dhe me parimet e tolerancës”; paragrafin 5: “pjesëmarrja e fëmijëve është shumë e rëndësishme për të ndikuar në kushtet e jetesës së tyre, në kuptimin që pjesëmarrja nuk ka të bëjë vetëm me përfshirjen në institucione dhe vendimmarrje, por mbi të gjitha është një formë e përgjithshme demokracie për të gjitha fushat e jetës familjare dhe sociale. Për më shumë shihni vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 16 dhjetor 1999, çështja *T.k. Mbretërisë së Madhe*, nr. 24724/94, paragrafi 83, dhe vendimin datë 16 dhjetor 1999, *V. kundër Mbretërisë së Madhe*, nr. 24888/94, paragrafi 85: “[...ç neni 6, i lexuar në tërësi, i cili garanton të drejtën e një të akuzuari për të marrë pjesë efektivisht në gjykimin penal kundër tij”.

32. Parimi i pjesëmarrjes, pra që fëmijët të kenë të drejtë të shprehin mendimin e tyre dhe të japin pikëpamjet e tyre në të gjitha çështjet që i prekin ata, është një ndër udhëzimet kryesore të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve⁹. Ndërsa kjo nuk do të thotë gjithmonë që mendimi i tyre do të reflektohet, udhëzimet kërkojnë që opinion i fëmijëve të merret seriozisht parasysh dhe të trajtohet me respekt, sipas moshës, pjekurisë së fëmijëve, dhe rrethanave të çështjes, e cila është objekt i të drejtës procedurale kombëtare.
33. Përmendja e termit “i aftë për të formuar pikëpamjet e tij ose të saj”¹⁰ nuk duhet të shihet si kufizim, por si detyrë e autoriteteve për të vlerësuar plotësisht kapacitetin e fëmijës sa më shumë të jetë e mundur. Në vend që të mendojnë lehtësisht që fëmija nuk është në gjendje që të formojë një opinion të vetin, shtetet duhet të prezumojnë që, në fakt, fëmija e ka këtë aftësi”. Nuk i takon fëmijës që ta provojë këtë gjë. Në përputhje me legjislacionin për të drejtat e fëmijëve, teksti në Pjesën III A.2 nënvizon mesazhin themelor që fëmijët janë mbajtës së të drejtave.
34. Shtetet nuk inkurajohen të prezantojnë kufij standard moshe¹¹. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime nënvizojnë po ashtu që “mosha nuk duhet të jetë pengesë për të drejtën e një fëmije për të marrë pjesë plotësisht në procesin e drejtësisë”¹².
35. Në çështjet familjare, fëmijët duhet të përfshihen në diskutim përpara marrjes së çdo lloj vendimi që ka ndikim në mirëqenien e tyre aktuale ose të ardhshme.

⁹ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 12.

¹⁰ Po aty. Neni 12.1

¹¹ Komentet e Përgjithshme për të Drejtën e Fëmijës për t’u dëgjuar, paragrafi 20-21 (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009).

¹² Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSOC Res 2005/20, 22 korrik 2005), paragrafi 18.

Të gjitha masat për të siguruar që fëmijët përfshihen në proceset gjyqësore duhet të jenë përgjegjësi e gjyqtarit, i cili duhet të verifikojë që fëmijët janë përfshirë në mënyrë efektive në proces dhe nuk janë të pranishëm vetëm atëherë kur vetë fëmijët kanë refuzuar të marrin pjesë në to, ose kur kanë pjekuri dhe nivel të tillë kuptimi që e bën të pamundur pjesëmarrjen e tyre. Organizatat vullnetare dhe avokatët e popullit për fëmijët duhet të bëjnë po ashtu të gjitha përpjekjet për t'u siguruar që fëmijët përfshihen në proceset e së drejtës familjare dhe nuk përballen me një fakt të kryer.¹³

Në një çështje që kishte të bënte me një minorene të akuzuar me nivel të ulët të të kuptuarit, Gjykata konstatoi se “pjesëmarrja efektive në këtë kuadër presupozon që i akuzuari ka kuptim të gjerë të procesit të gjykimit dhe të asaj se çfarë vihet në rrezik për të. Kjo do të thotë që ai ose ajo, nëse është e nevojshme, për shembull, me ndihmën e një përkthyesi, avokati, punonjësi social ose miku, duhet të jetë në gjendje të kuptojë thelbin e përgjithshëm të asaj çfarë thuhet në gjykatë. Fëmija duhet të jetë në gjendje të ndjekë se çfarë thuhet nga dëshmitarët e prokurorisë dhe, nëse përfaqësohet, duhet t'i shpjegojë avokatit të tij versionin e vet për ngjarjet, të identifikojë deklaratat me të cilat ai/ajo nuk është dakord dhe t'i bëjë atij të ditur faktet që duhet të përfshihen në mbrojtjen e tij/saj¹⁴. Për më tepër, “është e domosdoshme që fëmija të gjykohet në një gjykatë të specializuar, e cila është në gjendje të marrë parasysh plotësisht gjendjen e tij dhe të japë kompensimet e nevojshme për mangësitë në të cilat ai funksionon dhe të përshtatë procedurën e saj sipas nevojës¹⁵.

Po ashtu, në çështjen *Sahin k. Gjermanisë* gjykata doli në përfundimin në një çështje kujdestarie se “do të shkonte shumë larg të shprehej se gjykatave kombëtare u duhet gjithmonë që të dëgjojnë një fëmijë në gjykatë lidhur me mundësinë për të takuar

¹³ Disa shtete anëtare i penalizojnë prindërit për mosrespektim të kujdestarisë dhe për mosrealizim angazhimesh, duke mos përjashtuar faktin që mund të jetë fëmija ai që refuzon përputhshmërinë. Në shtete të tjera shtetet mund të japin dënime për kujdestarin për mospërbushje të një vendimi të gjykatës, ndërsa kjo gjë mund të ishte shmangur duke e përfshirë fëmijën në çdo vendim të marrë në emër të tij ose të saj.

¹⁴ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), datë 15 qershor 2004, *S.C. k. Mbretërisë së Madhe*, Nr. 60958/00, paragrafi 29.

¹⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, po aty, paragrafi nr. 35.

prindin që nuk ka kujdestari, por kjo gjë varet nga rrethanat e posaçme të secilës çështje, duke mbajtur parasysh moshën dhe pjekurinë e fëmijës në fjalë¹⁶.

Së fundmi, në një tjetër çështje kujdestarie, *Hokkannen k. Finlandës*, Gjykata u shpreh se një vajzë 12-vjeçare “është mjaftueshmërisht e pjekur për t’ju marrë parasysh pikëpamjet nga gjykata se, për pasojë, aksesit nuk duhet të jepet në kundërshtim me dëshirat e saj”¹⁷.

B. Interesat më të mira të fëmijës

36. Interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë elementi parësor i të gjitha çështjeve ku përfshihen fëmijë. Vlerësimi i situatës duhet të bëhet në mënyrë të saktë. Këto udhëzime promovojnë zhvillimin e metodave shumëdisiplinore për vlerësimin e interesave më të mira të fëmijëve, duke e pranuar që ky është ushtrim i vështirë. Ky vlerësim bëhet edhe më i vështirë kur këto interesa duhet të balancohen midis interesave të palëve të tjera të përfshira, të tillë si fëmijët, prindërit, viktimat, etj. Interesat më të mira të fëmijës duhet të vlerësohen në mënyrë profesionale, sipas karakteristikave rast pas rasti.

37. Interesat më të mira të fëmijës duhet të shqyrtohen gjithnjë në kombinim me të drejtat e tjera të fëmijëve, të tilla si, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për t’u mbrojtur nga dhuna, e drejta për të mos u ndarë nga prindërit, etj.¹⁸ Qasja përfshirëse duhet të përbëjë rregullin e përgjithshëm.

38. Është mbresëlënëse të shihet sa pak është bërë për parimin e “interesit më të mirë” të fëmijës në rastet e drejtësisë për të miturit, ndryshe nga çështjet që lidhen me të drejtën familjare. Ka një tendencë shqetësuese në pjesën më të

¹⁶ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 8 korrik 2003, *Sahin k. Gjermanisë*, nr. 30943/96, paragrafi 73.

¹⁷ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma), datë 23 shtator 1994, *Hokannen k. Finlandës*, nr. 19823/92, paragrafi 61.

¹⁸ Për më shumë sugjerime praktike shihni Udhëzimet e UNHCR-së për Përcaktimin e Interesave më të Mira të Fëmijëve, 2008 (www.unhcr.org/refworld/docid/148480c342.html).

madhe të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës drejt trajtimit si të rritur¹⁹ të fëmijëve që janë autorë veprash. Është e tepërt të thuhet që duhet të respektohet e drejta e të gjithë fëmijëve, përfshirë dhe fëmijët që e shkelin të drejtën. Qasja ndëshkuese strikte nuk është në përputhje me parimet e drejtësisë për të miturit, siç formulohen në nenin 40 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Fëmijëve²⁰. Ndërhyrjet e një natyre më shumë sociale dhe arsimore janë më shumë në përputhje me këtë instrument dhe kanë rezultuar të jenë më efektive edhe në praktikë²¹.

Në shumë çështje të së drejtës familjare, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka deklaruar se gjykatat e brendshme duhet të vlerësojnë pyetjen e vështirë të interesave më të mira të fëmijës mbështetur në një raport psikologjik të arsyetuar, të pavarur dhe të përditësuar dhe që fëmija, nëse është e mundur dhe në përputhje me pjekurinë dhe moshën e tij/saj, duhet të dëgjohet nga psikologu dhe gjykata për çështje të aksesit, banimit dhe kujdestarisë²².

Në çështjen *Bronda k. Italisë*, interesat më të mira të fëmijës konsideroheshin të tejkalonin të drejtat e palës tjetër të përfshirë: “ ... ndërsa duhet të gjendet një baraspeshë e drejtë ndërmjet interesit të S.-së për të qëndruar me prindërit e saj birësues dhe interesit të familjes së saj natyrale për ta mbajtur atë të jetojë me të, Gjykata i jep peshë të veçante interesave më të larta të fëmijës, e cila, tani 14 vjeç, ka dëshmuar me vendosmëri se nuk dëshiron të largohet nga familja e saj birësuese dhe

¹⁹ Shih T. Hammarberg (www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints) (2009)

²⁰ Koment i Përgjithshëm nr. 10 për të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Miturit (CRC/C/GC/10, 25 prill 2007), paragrafi 71. Shih po ashtu Rekomandimin e Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 20 mbi reagimet sociale për kriminalitetin tek të rinjtë.

²¹ Koment i Përgjithshëm nr. 10 për të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Miturit (CRC/C/GC/10, 25 prill 2007).

²² Cf. posaçërisht Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 13 korrik 2000, *Elshols k. Gjermanisë*, nr. 25735/94, paragrafi 53, dhe vendimin, datë 8 korrik 2003, *Sommerfeld k. Gjermanisë* nr. 31871/96, paragrafi 67-72. Shih po ashtu mendimin e pakicës nga Gjyqtari Ress, i përqafuar nga Gjyqtari Pastor Ridurejo dhe Turmen në çështjen *Summerfeld k. Gjermanisë* (po aty.), paragrafi 2.

të shkojë në familjen e saj natyrale. Në rastin në fjalë, interesat e S.-së kanë epërsi mbi interesat e gjyshërve të saj²³.

Një deklaratë e ngjashme është bërë nga Gjykata dhe në çështjen e përmendur më sipër *Sahin k. Gjermanisë*: “Neni 8 kërkon që autoritetet e brendshme duhet të gjejnë një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave të fëmijëve dhe interesave të prindërve të tyre dhe, gjatë procesit të balancimit, rëndësi e veçantë i duhet dhënë interesave më të mira të fëmijëve, të cilat, në varësi të natyrës dhe seriozitetit, mund të tejkalojnë interesat e prindërve. Në veçanti, një prind, mbështetur në nenin 8, nuk ka të drejtë të sigurojë marrjen e këtyre masave pasi ato dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës²⁴.

Në çështjen e birësimit *Pini dhe të Tjerët k. Rumanisë*, Gjykata vendosi lidhur me refuzimin e fëmijëve për t’u birësuar nga një familje e huaj: “Në çështje të tilla [...] interesat e fëmijëve, në varësi të natyrës dhe të seriozitetit të tyre, mund të tejkalojnë interesat e prindit²⁵.

C. Dinjiteti

39. Respektimi i dinjitetit është një kërkesë bazë për të drejtat e njeriut, e cila nënvizohet në shumë instrumente ekzistuese ligjore²⁶. Megjithëse në këtë kontekst janë të aplikueshme dispozita të ndryshme të Udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimin, rëndësi e veçantë i duhet kushtuar deklaratës në udhëzime që “çdo fëmijë është qenie njerëzore unike dhe e vyer

²³ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 8 qershor 1998, *Bronda K. Italisë*, nr. 22430/93, paragrafi 62.

²⁴ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 8 korrik 2003, *Sahin k. Gjermanisë*, nr. 30943/96, paragrafi 66.

²⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), datë 22 qershor 2004, *Pini dhe të Tjerët k. Rumanisë*, nr. 78028/01 dhe 78030/01, paragrafi 155.

²⁶ Shih, për shembull, preambulën e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe preambulën dhe nenin 40, paragrafi 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

dhe, si i tillë, duhet të respektohen dhe të mbrohen nevojat e posaçme, interesat dhe privacia e tij²⁷.

40. Teksti i C.2-it përsërit dispozitën e nenit 3 të KEDNj-së.

D. Mbrojtja nga diskriminimi

41. Edhe ndalimi i diskriminimit përbën një parim të përcaktuar mirë në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 2 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve konsiderohet si një ndër parimet udhëzuese për këtë qëllim. Teksti i D.1-it përmend disa shkaqe të njohura për diskriminim.

42. Lidhur me çështjen specifike të “racës”, Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), në Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme nr. 7 për legjislacionin kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin përcakton se: “përderisa të gjitha qeniet njerëzore i përkasin të njëjtës specie, ECRI i kundërshton teoritë e bazuara në ekzistencën e “racave” të ndryshme. Megjithatë, në këtë rekomandim, ECRI e përdor këtë term për t’u siguruar që personat që perceptohen përgjithësisht dhe gabimisht se i përkasin “një tjetër race” nuk përjashtohen nga mbrojtja që parashikohet në legjislacion”.

43. Disa kategori të fëmijëve posaçërisht vulnerabël mund të kenë nevojë për mbrojtje të posaçme në këtë aspekt. Teksti liston disa prej këtyre kategorive. Megjithatë lista nuk synon të jetë shteruese, pasi nuk mund të përjashtohen shkaqe të tjera diskriminimi.

²⁷ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (ECOSOC Res 2005/22, 23 korrik 2005), III.8.a dhe 1.6.

44. Një tjetër faktor i rëndësishëm diskriminimi në fushën e të drejtave të fëmijëve është mosha dhe zotësia ose aftësitë e tyre. Fëmijët shumë të rinj ose fëmijët pa kapacitet të plotë për të ndjekur të drejtat e tyre janë po ashtu posedues së të drejtës. Për këto fëmijë duhet të zhvillohen sisteme alternative përfaqësimi për të shmangur diskriminimin.

*E. Shteti i së drejtës*²⁸

45. Pa u përpjekur të përkufizojnë konceptin e “shtetit të të drejtës”²⁹, disa prej elementëve të tij janë dhënë në pikën E.1 dhe E.2. I gjithë teksti është ndikuar nga opinion i Gjykatës që “shteti i së drejtës, një ndër parimet themelore të një shoqërie demokratike, është i mëshiruar në të gjitha nenet e Konventës”³⁰. Për pasojë, ndikimi i tij duhet të ndihet në të gjitha proceset që përfshijnë fëmijët.

46. Shteti i së drejtës përcakton, *inter alia*, parimin themelor që çdokush është përgjegjës për respektimin e ligjeve të përcaktuara dhe të publikuara qartë dhe për të drejtat e zbatueshme. Ky parim zbatohet pavarësisht nga mosha, kështu që shtetet anëtare pritet të respektojnë dhe të mbështesin të drejtat themelore të të gjithëve, përfshirë dhe fëmijët. Zbatimi i shtetit të së drejtës lidhur me fëmijës bën të nevojshme, *inter alia*, zbatimin e së drejtës për prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor, përfshirë ndihëm e pavarur ligjore, të drejtën për t’ju drejtuar një gjyqtari, ose një tjetër

²⁸ Shih po ashtu raportin e sekretarisë së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut “Aksesi i fëmijëve në drejtësi – vëmendje e veçante për aksesin e fëmijëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe jurisprudencën e saj lidhur me aksesin e fëmijëve në juridiksionet kombëtare për “hartimin e teksteve të lidhura me drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve”, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe e Çështjeve Ligjore, 2009, f. 11-19.

²⁹ Brian Z. Tamanaha e ka gjurmuar idenë tek Aristoteli: “është më mirë që vendosë shteti i së drejtës sesa njëri nga qytetarët”, dhe vijon më tej: “në mënyrë që edhe rojtarët e ligjit ta respektojnë ligjin”, cituar nga Tom Bingham, *The rule of law*, Alan Lane, Penguin Group, 2010, faqe 3.

³⁰ *Ukraine-Tyumen k. Ukrainës*, nr. 22603/02, paragrafi 49, 22 nëntor 2007.

institucioni ose subjekti, i cili sipas të drejtës së brendshme është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

47. Për fëmijët parimet e *nullum crimen sine lege* dhe *nulla poena* janë po aq të vlefshme sa janë dhe për të rriturit dhe përbëjnë bazën e sistemit të së drejtës penale në një demokraci³¹. Megjithatë, kur trajtohen sjellje antisociale të fëmijëve, megjithëse jo kriminale, ka pasur tendencë në disa shtete anëtare që të zbatohen ndërhyrje me ndikime të largëta, përfshirë dhe mohimin e lirisë. Nën pretekstin e mbrojtjes së shoqërisë nga sjellja antisociale, fëmijët janë tërhequr në skena ndërhyrjeje në një mënyrë që nuk do të tolerohej nëse ata do të ishin të rritur. Garancitë standarde ligjore, të tilla si barra e provës për shtetin dhe e drejta për proces të rregullt ligjor nuk janë gjithnjë të pranishme. Në shumë shtete, nuk zbatohen plotësisht parimet bazë të së drejtës për çështjet penale si për fëmijët dhe për të rriturit. Fëmijët ende dënohen për të ashtuquajturit vepra “statusi” (akte që nuk përcaktohen si krime në të fushën e së drejtës dhe që nuk janë të dënueshme kur kryhen nga një i rritur)³².

48. Në mënyrë që shteti i së drejtës të respektohet me efektivitet dhe siç duhet, veçanërisht në marrëdhënie me fëmijët, mbi bazën e pikës E.3 shteteve anëtare u kërkohet të prezantojnë dhe/ose të mbajnë mekanizma të pavarur dhe efektivë ankimimi, duke pasur parasysh përshtatshmërinë e tyre me moshën dhe nivelin e të kuptuarit të fëmijës.

IV. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore

A. Elementë të përgjithshëm të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve

³¹ KEDNJ, neni 7; Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 40, paragrafi 2.1.

³² Shih CRIN “Raporti për veprat me “status” në adresën http://www.crin.org/docs/Status_Offences_doc_2_final.pdf.

49. Këto elementë të drejtësisë miqësore ndaj fëmijës janë të rëndësishme për të gjithë aktorët e mundshëm brenda ose jashtë proceseve gjyqësore dhe zbatohen pavarësisht statusit të fëmijës dhe aplikohen po ashtu dhe për grupe specifike të fëmijëve veçanërisht të cenueshëm.

1. Informimi dhe këshillimi

50. Në çdo rast individual, që prej kontaktit të parë me sistemin e drejtësisë dhe në çdo hap tjetër të rrugës, fëmijës i duhet dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm³³. Kjo e drejtë zbatohet njësoj si tek fëmijët viktimë, autorë të pretenduar të krimeve, ashtu si edhe mbi çdo palë tjetër të përfshirë ose të prekur³⁴. Megjithëse jo gjithmonë është praktike që të jepet informacion në fillim të përfshirjes së fëmijës me autoritetet përgjegjëse, një gjë e tillë duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, mund të ketë situata kur informacioni nuk duhet t'u jepet fëmijëve (kur ai është në kundërshtim me interesin e tyre më të mirë).

51. Fëmijët duhet të informohen për të drejtat e tyre³⁵, por edhe për instrumentet që mund të përdorin për të ushtruar realisht të drejtat e tyre ose për t'i mbrojtur ato kur është e nevojshme³⁶. Ky është kushti i parë për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në Pjesën IV.A.1, Udhëzimi 1 jep një listë të detajuar, por jo shteruese, të informacionit që duhet të marrin fëmijët dhe prindërit e tyre.

³³ Kjo është një detyrë e rëndësishme për avokatët e popullit për fëmijët dhe për organizatat për të drejtat e fëmijëve.

³⁴ Kjo e drejtë mbulohet nga shumë instrumente, të tilla si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (neni 13, paragrafi 1; 37, paragrafi d; 40, paragrafi 2.b(ii), 42) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (ECOSOC Res. 2005/20, 22 korrik 2005, VII) dhe Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (ETS Nr. 160, neni 3).

³⁵ Neni 42, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

³⁶ Informacioni nuk duhet të kufizohet tek informacioni ligjor por duhet, për shembull, të përfshijë informacion për praninë e avokatit të popullit për fëmijët ose të shërbimeve të tjera për fëmijët.

52. Fëmijët mund të përjetojnë dhënien e informacionit jo objektiv ose të paplotë. Prindërit jo gjithmonë ndajnë të gjithë informacionin e nevojshëm me fëmijët dhe ajo çfarë mund të japin prindërit mund të jetë e njëanshme. Në këtë kuadër, është shumë i rëndësishëm për fëmijët roli i avokatit, i avokatit të popullit për fëmijët dhe i shërbimeve ligjore për ta.
53. Udhëzimi 2 rikonfirmon të drejtën e fëmijës për të marrë informacion dhe këshillim në një gjuhë të kuptueshme, në përputhje me moshën, pjekurinë dhe kapacitetin e fëmijës.
54. Informacioni për sistemin procedural përfshin nevojën për informacion të detajuar për mënyrën sesi do të zhvillohet procedura, cili do të jetë qëndrimi dhe roli i fëmijës, si do të realizohen pyetjet, kur pritet të bëhen pyetjet, rëndësia dhe ndikimi i çdo dëshmie të dhënë, pasojat e një akti të caktuar, etj. Fëmijët duhet të kuptojnë se çfarë po ndodh, sesi mund ose do të zhvillohen më tej gjërat, çfarë opsionesh kanë dhe cilat janë pasojat e këtyre opsioneve. Ata duhet të informohen për alternativat e mundshme të proceseve. Në disa raste, mund të jetë më e përshtatshme ndërmjetësimi sesa ndërhyrja e gjykatës, ndërsa në raste të tjera rekursi në një gjykatë mund të ofrojë më shumë garanci për fëmijën. Pasojat e ndryshme të këtyre zgjidhjeve duhet t'i shpjegohen qartë fëmijës, në mënyrë që të merret një vendim pasi është marrë gjithë informacioni i nevojshëm, megjithëse fëmija mund të mos jetë domosdoshmërisht vendimmarrësi në çdo rast. Ky informacion mund të ofrohet po ashtu nëpërmjet një materiali miqësor ndaj fëmijës ku jepet informacioni përkatës ligjor (Udhëzimi 4).
55. Udhëzimi 5 parashikon detyrimin e dhënies së informacionit për të gjitha akuzat e ngritura kundër fëmijës në mënyrë të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë si për fëmijën dhe për prindërit dhe informacionin për të drejtat që gëzon fëmija në këto raste. Fëmijës duhet t'i jepet informacion dhe lidhur me vendimet e palës tjetër, zhvillimet përkatëse pas gjykimit dhe mënyrën sesi do të përcaktohen rezultatet e çështjes. Duhet të jepet informacion dhe lidhur

me mekanizmat e mundshme të ankimimit, sistemet e disponueshme të ndihmës ligjore, përfaqësimit ose këshilla të tjera të mundshme të cilat ata mund të kenë të drejtë t'i marrin. Kur jepet vendimi, arsyetimi duhet të jepet në mënyrë të tillë që fëmija ta kuptojë plotësisht atë. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për fëmijët me nevoja të posaçme arsimore, ose me nivele të ulëta arsimore.³⁷

56. Në rastin e së drejtës civile dhe mosmarrëveshjeve familjare ndërkufitare, në varësi të pjekurisë dhe të të kuptuarit, fëmija duhet të marrë informacion profesional lidhur me çështjet e aksesit në drejtësi në juridiksione të ndryshme dhe për ndikimet e proceseve gjyqësore në jetën e tij ose të saj. Fëmijët hasen me sfida të veçanta kur ka historik të konflikteve dhe/ose abuzimit në familje.

Në çështjen *V. dhe T. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata vërejtë se pjesëmarrja efektive në sallën e gjyqit presupozon që i akuzuari ka një kuptim të gjerë të natyrës së procesit të gjykimit, përfshirë dhe domethënien e ndëshkimit që mund të merret kundër tij. Për pasojë, të miturit e akuzuar për krime, në çdo rast, duhet të përfaqësohen nga avokatë të zot dhe me eksperiencë në trajtimin e fëmijëve.³⁸

Në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, për fëmijët ose të rinjtë janë vënë në dispozicion shërbime private ose të subvencionuara ku ata mund të marrin informacion mbi të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, ose informacion bazë për çështjet ligjore, ose informacion specifik për rastin ose situatën e tyre. Në disa shtete të caktuara anëtare, të tilla si në Belgjikë dhe Holandë, ekzistojnë të ashtuquajturit “dyqanet për të drejtat e fëmijëve”³⁹ të cilat mund t'i drejtojnë fëmijët tek avokati,

³⁷ Informacioni mund të duhet të përkthehet në një gjuhë që kuptohet nga fëmija (një gjuhë e huaj, në brail, ose një gjuhë tjetër), ashtu siç ndodh dhe për të rriturit, ndërsa duhet të shpjegohet terminologjia formale ligjore në mënyrë që fëmija ta kuptojë plotësisht atë.

³⁸ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 16 dhjetor 1999, *T.K. Mbretërisë së Madhe*, nr. 24724/94, paragrafi 88 dhe vendimi datë 16 dhjetor 1999, *V. k. Mbretërisë së Madhe*, nr. 24888/94, paragrafi 90.

³⁹ “*Kinderrechtswinkel*” në Gent dhe Bruzha dhe “*Service droit des jeunes*” në qytetet më të mëdha në komunitetin frëngjishtfolës në Belgjikë.

mund t'u japin ndihmë për ushtrimin e të drejtave të tyre (për shembull, t'i shkruajnë një gjyqtari për t'u dëgjuar në seancë gjyqësore), etj.

2. Mbrojtja e të drejtës private dhe familjare

57. Anonimati dhe mbrojtja e të dhënave personale nga masmedia mund të jenë të nevojshme për fëmijën, ashtu siç parashikohet në shumë instrumente.⁴⁰ Në këtë kuadër, duhet të përmendet posaçërisht Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr. 108)⁴¹, në të cilën jepet një listë e standardeve përgjithësisht të pranuar lidhur në veçanti me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe me cilësinë e të dhënave. Ashtu si edhe në rastin e KEDNJ-së, fëmijët i gëzojnë të gjitha të drejtat mbështetur në këtë konventë megjithëse ajo nuk i referohet shprehimisht të drejtave të fëmijëve. Për më tepër, neni 6 parashikon garanci të posaçme kur bëhet fjalë për të dhëna të ndjeshme, të tilla si të dhënat personale të lidhura me dënimet penale. Kategori të tjera të të dhënave mund të përcaktohen si të ndjeshme nga e drejta e brendshme, ose të trajtohen si të tilla nga autoritetet publike duke lejuar për një mbrojtje më të mirë të privacisë së fëmijëve. Sa për shembull, instrumenti⁴² liston kategoritë e mëposhtme: proceset disiplinore, regjistrimin e çështjeve të

⁴⁰ Sa për shembull, neni 113 i Konventës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS Nr. 197) merret me privacinë dhe mbron të dhënat personale ndërsa u bën thirrje shteteve të krijojnë masa rregullatore për shtypin. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSOC Res 2005/20, 22 korrik 2005), paragrafi X, 27, thuhet se: "Informacioni që lidhet me përfshirjen e një fëmije në procesin gjyqësor duhet të mbrohet. Kjo mund të arrihet duhet ruajtur konfidencialitetin dhe duke kufizuar bërjen publike të informacionit që mund të çojë në identifikimin e fëmijës që është viktimë ose dëshmitar në një provës gjyqësor". Kjo përshkruhet po ashtu në Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë tek të Miturit (Rregullat e Bejxhingut, 1985, neni 8): "E drejta e të miturve për privaci duhet të respektohet në të gjitha fazat për të shmangur dëmtimin për shkak të publicitetit të pavend, ose nëpërmjet procesit të etiketimit. Në parim, asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijëve autorë krimesh nuk duhet të botohet".

⁴¹ Ky instrument ka zë ndërkombëtar, pasi është i hapur për pranim edhe nga shtetet jo anëtare të Këshillit të Evropës në rast se legjislacioni i tyre i përmbush kërkesat e Konventës.

⁴² Opinioni 2/2009 i Grupit të Punës për Mbledhjen e të Dhënave në BE për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Fëmijëve (Udhëzimet e përgjithshme dhe rasti i veçantë i shkollave).

dhunës, trajtimin mjekësor në shkolla, orientimin shkollor, arsimimin e posaçëm për personat me aftësi të kufizuar dhe ndihmën sociale për nxënësit nga familjet e varfra.

58. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 10 për të Drejtat e Fëmijëve për Drejtësinë e të Miturve⁴³, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve rekomandon, ndërmbjet të tjerash, organizimin e seanceve me dyer të mbyllura, ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, dhënin e vendimit pa zbuluar identitetin e fëmijës, etj. Gjykata përfshin dhe mundësinë e gjykimit të çështjeve me dyer të mbyllura në rast se kjo kërkohet nga interesi më i mirë i fëmijës, ose për privacinë e tij/saj⁴⁴ dhe Udhëzimi 9 u kujton shteteve anëtare këtë praktikë të mirë. Megjithatë, ky parim duhet të përputhet me parimin e aksesit të lirë në proceset gjyqësore, parim i cili është i pranishëm në shumë shtete anëtare.

59. Mënyra të tjera për të ruajtur privacinë janë, ndër të tjera, dhënia e anonimatit ose vënia e një pseudonimi, përdorimi i ekraneve ose ndryshimi i zërit, heqja e emrave dhe e elementëve të tjerë që mund të çojnë në identifikimin e një fëmije nga të gjitha dokumentet, duke ndaluar çdo formë regjistrimi (foto, audio, video), etj.

60. Shtetet anëtare kanë detyrime pozitive në këtë kuadër. Udhëzimi 7 thekson se monitorimi i kodeve ose ligjshmërisht të detyrueshme ose i kodeve profesionale të sjelljes për shtypin janë të domosdoshme për shkak se dëmtimet e bëra pas botimit të emrave dhe/ose fotove shpesh janë të pariparueshme.

61. Megjithëse parimi udhëzues është mbajtja e informacionit identifikues të paaksesueshëm nga publiku i përgjithshëm dhe nga media, mund të ketë raste

⁴³ Koment i Përgjithshëm nr. 10 për të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për të Miturit (CRC/C/GC/10, 25 prill 2007)

⁴⁴ Rregullorja e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 63.

ku në mënyrë përjashtimore fëmija mund të përfitojë nëse çështja bëhet e ditur, ose madje dhe kur botohet gjerësisht, si, për shembull, kur fëmija rrëmbehet. Po ashtu, çështja në diskutim mund të përfitojë nga ekspozimi publik për nxitjen e këshillimit ose për rritjen e ndërgjegjësimit.

62. Çështja e privacisë është veçanërisht e rëndësishme në kuadrin e disa masave të synuara për të trajtuar sjelljen antisociale të fëmijëve. Më specifikisht, zbatimi i të ashtuquajturve Urdhra për Sjellje Antisociale në Mbretërinë e Bashkuar, përfshirë dhe politikat e “vënies së gishtit tek përgjegjësitet dhe turpërimit”, tregojnë se në këto raste të dhënat personale jo gjithmonë nuk i bëhen me dije publikut të përgjithshëm. Udhëzimi 10 përcakton detyrimin strikt në këtë aspekt lidhur me të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët, në përjashtim të rasteve kur ekziston rreziku i dëmtimit të fëmijës (shih nenin 12 të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual, CETS nr. 201).

Në çështjen *B. dhe P. kundër Mbretërisë së Madhe*, Gjykata u shpreh që proceset lidhur me qëndrimin e fëmijës pas divorcit ose ndarjes janë shembuj tipikë të çështjeve ku përjashtimi i shtypit dhe i publikut mund të justifikohen për të mbrojtur privacinë e fëmijës dhe të palëve të tjera dhe për të shmangur paragjykimin në interes të drejtësisë⁴⁵.

Më tej, në çështjen *V k. Mbretërisë së Madhe*, Gjykata u shpreh se: “rezulton se, lidhur me një fëmijë të vogël të akuzuar për një vepër të rëndë që tërheq nivele të larta të interesit të medias dhe të interesit publik, është e nevojshme që seancat të zhvillohen në një mënyrë të tillë saqë të ulet sa më shumë të jetë e mundur ndjesia e frikësimit dhe e ndalimit për fëmijën”⁴⁶.

⁴⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 24 prill 2001, *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36337/97 dhe 35974/97, paragrafi 28.

⁴⁶ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 16 dhjetor 2009, *V. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24888/94, paragrafi 87.

Në rastet e përmendura më sipër të *V. dhe T. kundër Mbretërisë së Madhe*, të lidhura me procese penale kundër dy djemve të rinj të cilët vranë një fëmijë të vogël, gjykata u shpreh ndër të tjera, se: “[...] është e domosdoshme që një fëmijë i akuzuar për një vepër të trajtohet në një mënyrë që merr parasysh plotësisht moshën, nivelin e pjekurisë dhe aftësinë intelektuale dhe emocionale të tij dhe që të merren masa për të promovuar aftësinë e tij për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në proces.”⁴⁷ Më tej, Gjykata thekson se: “rezulton se, lidhur me një fëmijë të akuzuar për një vepër të rëndë që tërheq një nivel të lartë interesi nga media dhe publiku, është e nevojshme që seancat të kryhen në mënyrë të tillë që të ulen sa më shumë të jetë e mundur ndjenjat e frikës dhe të ndalimit për fëmijën”⁴⁸.

3. Siguria

63. Lidhur me fëmijët si viktimë, këto udhëzime janë frymëzuar nga parimet e Udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë për Çështje që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime⁴⁹ dhe Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual, të cilat bëjnë thirrje për ofrimin e sigurisë për fëmijët, familjet dhe dëshmitarët në emër të tyre nga kërcënimet, reprezaljet dhe viktimizimin e përsëritur⁵⁰.

64. Udhëzimi 11 kujton se fëmijët, veçanërisht fëmijët vulnerabël, duhet të mbrohen nga dëmtimet, pavarësisht se çfarë forme kanë ato. Ai është frymëzuar nga shumë dispozita ekzistuese me këtë efekt.

⁴⁷ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 16 dhjetor 1999, *T. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24724/94, paragrafi 84, dhe *V. k. Mbretërisë së Madhe*, nr. 24888/94, paragrafi 86.

⁴⁸ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 16 dhjetor 1999, *T. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24724/94, paragrafi 84, dhe *V. k. Mbretërisë së Madhe*, nr. 24888/94, paragrafi 86.

⁴⁹ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështje që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSOC Res 2005/20, 22 korrik 2005).

⁵⁰ Neni 31.1.f.

65. Ushtrimi i kontrollit mbi personelin që merret me shërbimet ndaj fëmijëve për të siguruar mbrojtjen e tyre, siç rekomandohet nga Udhëzimi 12, është prezantuar në disa shtete anëtare, përfshirë dhe kontrollin e historikut kriminal dhe marrjen e masave paraprake kur pretendohet që një person ka kryer vepra penale kundër fëmijëve. Sigurisht që ky ushtrim duhet të respektojë prezumimin e pafajësisë dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor.

66. Udhëzimi 63 bën thirrje për parimin themelor të nevojës së posaçme për mbrojtje kur autori mendohet të jetë një prind, një tjetër anëtar i familjes, ose një kujdestar parësor.

4. Trajnimi i profesionistëve

67. Trajnimi për aftësitë komunikuese, përdorimin e gjuhës miqësore ndaj fëmijëve dhe zhvillimin e njohurive për psikologjinë e fëmijëve është i nevojshëm për të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët (policët, avokatët, gjyqtarët, ndërmjetësuesit, punonjësit socialë, dhe ekspertë të tjerë), siç parashikohet nga Udhëzimi 14. Megjithatë, pak prej tyre kanë njohuri për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet procedurale në këtë kuadër.

68. Të drejtat e fëmijëve mund dhe duhet të jenë pjesë e kurrikulës shkollore dhe e fushave specifike në arsimin e lartë (juridik, psikologji, punë sociale, trajnimet për policinë, etj.). Në to duhet të mbulohen specifikat e të drejtave të fëmijëve dhe legjislacioni që lidhet me çështjet e fëmijëve, të tilla si e drejta familjare, drejtësia penale, e drejta e azilkërkimit dhe e drejta e imgracionit, etj. Shtetet anëtare inkurajohen të krijojnë kurse specifike trajnimi.

69. Konferenca e Toledos, e përmendur më sipër (shih paragrafin 6 më sipër) arriti në përfundimin se: “Të gjithë profesionistët, në veçanti gjyqtarët, psikologët dhe avokatët që merren me fëmijët në drejtësi, duhet të marrin informacionin,

ndërgjegjësimin dhe trajnimin e nevojshëm për teknikat e duhura të intervistimit”⁵¹.

Për shumë vjet, Dhoma e Avokatisë Flamenge dhe Komisioni i Rinisë në të u kanë ofruar anëtarëve të vet një kurs 2-vjeçar për të drejtat e fëmijëve. Informacioni ligjor plotësohet me trajnim bazë në psikologjinë e fëmijës dhe në trajnimin zhvillimor dhe praktik, të tillë si komunikimi me fëmijët. Pjesëmarrja në të gjitha modulet është e detyrueshme për të marrë një certifikatë si “avokat i ri”. Në vitin 2010 janë trajnuar rreth 400 avokatë për të rinjtë.⁵²

5. Qasja shumëdisiplinore

70. Teksti i udhëzimeve në tërësi, dhe Udhëzimet 16 deri në 18 në veçanti, i inkurajojnë shtetet anëtare të forcojnë qasjen ndërdisiplinore kur punojnë me fëmijët.

71. Në rastet ku përfshihen fëmijët, gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë duhet të përfitojnë nga mbështetja dhe nga këshillat e profesionistëve të disiplinave të tjera kur merren vendime të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi mirëqenien aktuale ose të ardhshme të fëmijës, si për shembull, për vlerësimin e interesit më të mirë të fëmijës, efektet e mundshme të dëmshme të procedurës për fëmijën, etj.

72. Qasja shumëdisiplinore është posaçërisht e rëndësishme për fëmijët në konflikt me ligjin. Të kuptuarit ekzistues dhe gjithnjë e në rritje për psikologjinë, nevojat, sjelljen dhe zhvillimin e fëmijëve nuk ndahet gjithmonë aq sa duhet me profesionistët e fushave të zbatimit të ligjit.

⁵¹ www.coe.int/t/dghl/standardsetting/children/Toledoconference_en.asp.

⁵² Për më shumë informacion (në flamisht) shih adresën www.jeugdadvocaat.be.

Në Islandë, Norvegji dhe Suedi, rastet e abuzimit dhe të dhunës mund të trajtohen në të ashtuquajturat shtëpitë e fëmijëve. Profesionistët nga shërbime sociale, ekspertët e mjekësisë mjekoligjore, pediatri, oficerët e policisë dhe prokurorët punojnë së bashku fillimisht në fazat fillestare të hetimit policor ose të shërbimeve sociale. Ata organizojnë dhe ndajnë detyrat e ndryshme të lidhura me këtë proces. Në këto shtëpi realizohen intervistimet me fëmijët e përfshirë në procese, ku ekziston dhe mundësia e një pale të tretë që të dëgjojë me anë të një lidhjeje me video në dhomën ngjitur. Ka edhe dhoma për ekzaminim mjekësor të fëmijëve dhe për këshillim.

6. Mohimi i lirisë

73. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës sesi trajtohen fëmijët e ndaluar për shkak të vulnerabilitetit të tyre të brendshëm. Masat praktike për ndalimin e fëmijëve sugjerohen në shumë instrumente të Këshillit të Evropës, për shembull, në Rekomandimin CM/Rec(2008)11 për Rregullat Evropiane për fëmijët që janë autorë krimesh dhe objekt sanksionesh ose masash, ose në standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues⁵³. Siç tregohet dhe në instrumentin e mëparshëm, duhet të merren masa të posaçme për të shmangur paraburgimin. Organet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve janë shumë kritike rreth përdorimit të tij dhe po kërkojnë ta ulin atë.⁵⁴ Megjithatë, paraburgimi mund të jetë i nevojshëm në raste të caktuara, si, për shembull, për të shmangur rrezikun e shkatërrimit të provave, ndikimin e dëshmitarëve ose kur ka rrezik për ndonjë marrëveshje të fshehtë ose largim, etj.

⁵³ Standardet e CPT-së (CPT/inf/E (2002) 1, Rish. 2009 në adresën www.cpt.coe.int/en/docsstandards.htm).

⁵⁴ Shih, për shembull, Konstatimet Përmbyllëse për Belgjikën: "Komiteti rekomandon që shteti palë: ... c) ... të sigurojë që në përputhje me nenin 37 të Konventës, mohimi i lirisë të përdoret si masë fundore, kohëzgjatja të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundshme, garancitë e procesit të rregullt të respektohen plotësisht dhe që personat nën 18 vjeç të mos mbahen të ndaluar bashkë me të rriturit." (CRC/C/15/Add. 178, paragrafi 32, c, 13 qershor 2002).

74. Përderisa ka aktualisht standarde të shumta për të drejtat e fëmijëve që u është mohuar liria,⁵⁵ nuk është e nevojshme që ato të përsëriten në udhëzime. Parimi kryesor është që në rastin e mohimit të lirisë fëmijës nuk i kufizohet asnjë e drejtë tjetër përveç të drejtës për të qenë i lirë. Ashtu siç jepet qartë në Udhëzimin 19 deri në 20, mjetet efektive që përfshijnë ndalimin, në çfarëdolloj forme që të jetë ai, duhet të shmangen sa më shumë të jetë e mundur dhe duhet thjesht të shërbejnë si mjet i fundit, duhet të përdoret për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe të kufizohet në raste të rënda⁵⁶. Ky përbën një detyrim ligjor jetik. Për më tepër, njihet gjerësisht që ndalimi nuk e ul rrezikun e recidivizmit.

75. Siç u theksua më sipër, seksionet për mohimin e lirisë dhe policinë nuk synojnë të japin një listë shteruese të të drejtave dhe lirive, por përfaqësojnë një minimum absolut të të drejtave që duhet të gëzohen nga fëmijët. Udhëzimi 21 duhet të lexohet nën këtë optikë.

76. Çështja nëse duhen mbajtur të ndaluar fëmijët me të rriturit nuk është çështje e re. Në disa raste, si ato që përfshijnë të miturit, mund të jetë në interesin më të mirë të fëmijës që fëmija të mos ndahet nga një prind i ndaluar, ose në rastin e fëmijëve të të ndaluarve imigrantë të cilët nuk duhet të ndahen nga familja e tyre. Shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës besojnë se në zonat e mëdha të populluara pak, mund të jetë përjashtimisht në interesin më të mirë të fëmijës që të mbahet i ndaluar në mjediset e të të rriturit (duke lehtësuar, për shembull vizitat nga prindërit, të cilët, për shembull, mund të banojnë qindra kilometra larg). Megjithatë, këto raste kërkojnë vigjilencë të posaçme nga autoritetet ndaluese në mënyrë që të ndalohet abuzimi i fëmijëve nga të rriturit.

⁵⁵ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, nenet 37 dhe 40.

⁵⁶ Rekomandimi i Komitetit të Ministrave, CM/Rec(2008) 11, paragrafi 59.1.

77. Megjithatë, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve ka qenë shumë i qartë për këtë çështje, mbështetur në nenin 37.c të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Rekomandimi i përmendur më sipër CM/Rec(2008)11 deklaron po ashtu që fëmijët nuk duhet të mbahen të ndaluar në të njëjtat institucione të përdorura për të rriturit, por duhet të mbahen në institucione të projektuara posaçërisht për ta.

78. Shumë referenca nënvizojnë se udhëzimet aplikohen për fëmijët që kërkojnë azil dhe që këtij grupi të posaçëm vulnerabël i duhet kushtuar vëmendje e posaçme; minoreneve të pashoqëruar, pavarësisht nëse janë ose jo azilkërkues, nuk u duhet mohuar liria vetëm si rezultat i mungesës së statusit të rezidencës (Udhëzimi 22).

Në çështjen *Guvec k. Turqisë*, Gjykata ka nënvizuar komentet e veta për periudhat e tejzgjatura të ndalimit. Ajo ka thënë shprehimisht: “në të paktën tri vendime të lidhura me Turqinë, Gjykata ka shprehur mosbesimin e saj rreth praktikës të ndalimit në paraburgim (shih *Selçuk k. Turqisë*, nr. 21768/02, paragrafi 35, 10 janar 2006; *Kosti dhe të Tjerët k. Turqisë*, nr. 74321/01, paragrafi 30, datë 3 maj 2007; çështja e përmendur më sipër *Nart k. Turqisë*, 20817, paragrafi 34) dhe ka konstatuar shkelje të nenit 5, paragrafi 3 i Konventës për periudha shumë të shkurta kohe të kaluara në paraburgim sesa periudha e kaluar në paraburgim nga aplikanti në çështjen në fjalë. Për shembull, në çështjen *Selçuk* aplikanti kishte kaluar katër muaj në paraburgim kur kishte qenë 16 vjeç, ndërsa në çështjen *Nart*, aplikanti kishte kaluar 48 ditë në paraburgim kur kishte qenë 17 vjeç. Në çështjen nën shqyrtim, aplikanti është ndaluar në moshën 15 vjeçare dhe u mbajt në paraburgim për më shumë se katër vjet e gjysmë. Nën dritën e shtjellimit më sipër, Gjykata shprehet se kohëzgjatja e ndalimit të aplikantit në paraburgim është e tepërt dhe në shkelje të nenit 5, paragrafi 3 të Konventës⁵⁷.”

⁵⁷ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), datë 20 janar 2009, *Guvec k. Turqisë*, nr. 70337/01, paragrafi 109-110.

B. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve përpara proceseve gjyqësore

79. Një çështje komplekse por e rëndësishme është ajo e moshës minimale për përgjegjësi penale. Ajo është e ndryshme në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe fillon që nga moshë 8 vjeçare dhe shkon deri tek moshë kur individit arrijnë moshën madhore. Teksti i Udhëzimit 23 është frymëzuar nga Rekomandimi CM/Rec(2008)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për rregullat evropiane për fëmijët autorë veprash dhe objekt sanksionesh ose masash. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve nuk përcakton ndonjë moshë, por Komenti i Përgjithshëm nr. 10 për të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë për Minorenët i këshillon shtetet anëtare që të mos e përcaktojnë shumë ulët këtë prag. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit transmetojnë një mesazh të ngjashëm. Rrjeti Evropian i Avokatëve të Popullit për Fëmijët (ENOC) rekomandon që moshë të rritet në 18 vjeç dhe rekomandon zhvillimin e sistemeve novatore për t'ju përgjigjur të gjithë autorëve të krimeve nën moshën madhore, të cilat përqendrohen posaçërisht tek (ri)edukimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i tyre.
80. Në përgjithësi duhet të promovohet dhe të zbatohet qasja parandaluese dhe riintegruuese në çështjet e drejtësisë për të miturit. Sistemi i drejtësisë penale nuk duhet të vihet automatikisht në lëvizje nga veprat e kryera nga fëmijët, në rastet kur mund të jenë më të suksesshme masa më konstruktive dhe më edukative. Për më tepër, shtetet anëtare duhet t'u përgjigjen veprave në përpjesëtim të drejtë jo vetëm me rrethanat dhe gravitetin e një veprë, por edhe me moshën, fajësinë më të pakët, nevojat e fëmijëve dhe nevojat e shoqërisë.
81. Udhëzimet 24 deri në 26 kujtojnë se në disa shtete anëtare vëmendja është përqendruar tek zgjidhja e konflikteve jashtë gjykatës, *inter alia*, nëpërmjet ndërmjetësimit familjar, shmangies dhe drejtësisë restorative. Ky është zhvillim pozitiv dhe shtetet anëtare inkurajohen që të sigurojnë që fëmijët të

mund të përfitojnë nga këto procedura, me kusht që ato nuk përdoren si pengesë për realizimin e të drejtës së fëmijës për akses në drejtësi.

82. Praktika të tilla ekzistojnë në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe mund t'i referohen dhe praktikave përpara, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore. Ato janë posaçërisht të rëndësishme në fushën e drejtësisë për të miturit. Këto udhëzime nuk i japin preferencë alternativave jogjyqësore dhe duhet të zbatohen dhe brenda tyre, në veçanti në konfliktet familjare, të cilat nuk përfshijnë vetëm çështje strikte ligjore. E drejta ka kufizimet e veta në këtë fushë dhe mund të ketë efekte të dëmshme në aspektin afatgjatë. Organizimet e ndërmjetësuara raportohen se janë më shumë të respektuara, për shkak të përfshirjes më aktive të palëve përkatëse. Edhe fëmijët duhet të jenë në gjendje të luajnë rol në to. Mund të shqyrtohet dhe mundësia e referimit të detyrueshëm tek shërbimet e ndërmjetësimit përpara proceseve të gjykatës: kjo nuk do të thotë që njerëzit të detyrohen të ndërmjetësojnë (gjë e cila do të ishte në kundërshtim me të gjithë idenë e ndërmjetësimit), por të gjithëve duhet t'u jepet mundësia të jenë në dijeni të kësaj mundësie.

83. Ndërsa ekziston një besim i përgjithshëm që fëmijët duhet të mbahen sa më shumë të jetë e mundur jashtë gjykatave, procedura e gjykatës nuk është domosdoshmërisht më e keqe se një alternativë jashtë gjykate, për aq kohë sa ajo është në përputhje me drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve. Ashtu si edhe ambientet e gjykatave, zgjidhjet alternative mund të përfshijnë po ashtu rreziqe lidhur me të drejtat e fëmijëve, të tilla si rreziku për zbehjen e respektimit të parimeve themelore si prezumimi i pafajësisë, e drejta për këshillim ligjor, etj. Për pasojë, çdo zgjidhje e bërë duhet të marrë parasysh cilësinë e qartë të një sistemi të caktuar.

84. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 12, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve rekomandon që⁵⁸: “në rast devijimi, përfshirë dhe ndërmjetësimin, fëmijës i duhet dhënë mundësia të japë pëlqimin e lirë dhe vullnetar dhe mundësia të përfitojë këshillim, ndihmë ligjore dhe ndihmë të llojeve të tjera për përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së devijimit të propozuar”. Megjithatë, Udhëzimi 26 kërkon që fëmijëve t’u garantohen nivele ekuivalente garancish si në proceset gjyqësore dhe në ato jashtëgjyqësore.

85. Në përmbledhje, teksti i udhëzimeve inkurajon akses në gjykatat kombëtare për fëmijët si mbajtës së të drejtave, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, tek e cila ata kanë akses nëse dëshirojnë akses. Megjithatë, ky akses balancohet dhe i pajtohet me alternativat e proceseve gjyqësore.

Në kantonin e Friburgut në Zvicër është përgatitur një skemë ndërmjetësimi për fëmijët në konflikt me ligjin. Duke kërkuar për një baraspeshë ndërmjet ndreqjes së padrejtësisë dhe ndëshkimit, ndërmjetësimi merr parasysh të drejtat dhe interesat e viktimës dhe të autorit të veprës. Në rastet kur plotësohen kritere të caktuara, gjyqtari mund ta referojë çështjen tek ndërmjetësimi. Ndërsa ndërmjetësi është përgjegjës për procesin e ndërmjetësimit, është gjyqtari ai që mbetet përgjegjës për çështjen penale. Pavarësisht nëse bihet dakord ose jo ndërmjet palëve, rezultati i ndërmjetësimit i komunikohet gjyqtarit, i cili ose njofton marrëveshjen (me shkrim), ose vijon me proceset gjyqësore në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje.

Në Norvegji, çiftet me fëmijë nën moshën 16 vjeç që kërkojnë divorc duhet të mundohen t’i nënshtrohen ndërmjetësimit përpara se të jenë në gjendje të çelin një procedure gjyqësore. Qëllimi është që t’u vihet në ndihmë prindërve të arrijnë një marrëveshje miqësore lidhur se me kë do të jetojnë fëmijët, lidhur me ushtrimin e

⁵⁸ Komenti i Përgjithshëm nr. 12 për të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 59.

përgjegjësi prindërore dhe të drejtat për vizita, duke siguruar marrjen parasysh të interesave më të mira të fëmijëve.

C. Fëmijët dhe policia

86. Udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve duhet të zbatohen edhe nga policia. Kjo aplikohet për të gjitha situatat kur fëmijët duhet të hyjnë në kontakt me policinë dhe, siç parashikohet në Udhëzimin 27, kjo ka rëndësi shumë të madhe kur bëhet fjalë për fëmijët vulnerabël.

87. Është e dukshme që qëndrimi miqësor ndaj fëmijës duhet të jetë i pranishëm në situata potenciale rreziku, të tilla si arrestimi ose marrja në pyetje e fëmijëve, të cilat mbulohen nga Udhëzimi 28 dhe 29. Në përjashtim të rasteve përjashtimore, prindërit duhet të njoftohen menjëherë për arrestimin e fëmijëve të tyre. Fëmija duhet të ketë gjithnjë të drejtë të flasë me një avokat, ose me çdo subjekt tjetër, i cili, sipas të drejtës së brendshme, është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të njoftojë prindërit ose një person të cilit ai/ajo i beson. Kontakti me shërbimet e mbrojtjes duhet të ofrohet që në momentin e arrestimit.⁵⁹ Vetëm në rast se nuk janë të disponueshëm prindërit duhet të kontaktohet një person tjetër të cilit fëmija i beson (si për shembull gjyshërit).

88. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Degradues (CPT) ka zhvilluar një sërë standardesh të cilat zbatohen për ndalimin e fëmijëve në polici. Përveç kësaj, në komentet për projektregulloren evropiane për fëmijët që janë autorë veprash⁶⁰ është theksuar shprehimisht që kjo rregullore duhet të përcaktojë shprehimisht që

⁵⁹ Një vendim i kohëve të fundit i një gjykate belge për fëmijët (Antwerp, 15 shkurt 2010) e deklaroi të pafajshëm një fëmijë që kishte kryer një krim për shkak se gjyqtari konstatoi se atij i ishin shkelur të drejtat e mbrojtjes pasi nuk kishte marrë ndihmën e avokatit gjatë seancave të pyetjes nga policia, gjatë të cilave ai pretendoi se ishte detyruar ta pranonte veprën për të cilën akuzohej. Gjyqtari përfundoi duke thënë se ishte shkelur nenin 6 i KEDNj-së.

⁶⁰ CPT, Raporti i Përgjithshëm nr. 18 (2007-2008), paragrafi 24.

fëmijëve të ndaluar nga policia nuk duhet t'u kërkohet që të bëjnë asnjë deklaratë, ose të nënshkruajnë ndonjë dokument të lidhur me veprën të cilën ata dyshohen të kenë kryer pa praninë e një avokati ose të një personi të besuar i cili mund t'u vijë në ndihmë. Këto standarde mbështeten në Udhëzimin 30. Shtetet mund të konsiderojnë mundësinë e prezantimit të njësisë të posaçme policore të trajnuara për këto detyra.

Në çështjen *Okkali k. Turqisë* Gjykata analizoi çështjen e një 12-vjeçari i cili ishte mbajtur nën arrest policie dhe që pretendonte se ishte keqtrajtuar. Gjykata u shpreh se ai duhet të kishte gëzuar më shumë mbrojtje si minorenen dhe se autoritetet nuk kishin marrë parasysh cenueshmërinë e tij të posaçme. Gjykata shtoi se në çështje të tilla të ngjashme, për t'i ardhur në ndihmë fëmijës duhet të caktohet një avokat (ose përfaqësues ligjor) dhe duhet të njoftohen prindërit për ndalimin.⁶¹

Në çështjen *Salduz k. Turqisë*, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-ës pasi një 17-vjeçari të dyshuar për një vepër nuk i ishte ofruar asistencë e një avokati gjatë pesë ditëve qëndrimi në rajonin e policisë. Gjykata u shpreh se “në mënyrë që e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 6, paragrafi 1, të mbetet “praktike dhe efektive”, si rregull, aksesit tek avokati duhet të ofrohet që në marrjen e parë në pyetje të të dyshuarit nga policia ...⁶². Gjykata vërejti po ashtu që një ndër elementët specifikë të kësaj çështje ishte mosha e aplikantit. Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të instrumenteve ndërkombëtare ligjore përkatëse përsa i përket ndihmës ligjore për minorenenët e ndaluar nga policia, Gjykata vlerësoi rëndësinë jetike të të kontaktuarit me një avokat në rastet kur personi i ndaluar nga policia është minorenen⁶³.

D. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve gjatë proceseve gjyqësore

⁶¹ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), datë 17 tetor 2006, *Okkali k. Turqisë*, nr. 52067/99, paragrafi 69, etj.

⁶² Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 27 nëntor 2008, *Salduz k. Turqisë*, nr. 36391/02, paragrafi 55.

⁶³ Po aty, paragrafët 56-62.

89. Këto elementë të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve duhet të aplikohen në të gjitha proceset: në proceset civile, penale dhe administrative.

1. Aksesi në gjykata dhe në procesin gjyqësor

90. Megjithëse fëmijët ligjshëmrisht konsiderohen se janë mbajtës të të drejtave, siç parashikohet nga Udhëzimi 34, ata shpesh nuk janë në gjendje t'i ushtojnë me efektivitet këto të drejta. Në vitin 1990, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës nënvizoi në Rekomandimin 1121 (1990) për të drejtat e fëmijëve që "fëmijët kanë të drejta të cilat mund t'i ushtojnë vetë në mënyrë të pavarur, madje dhe kundër të rriturve kundërshtarë⁶⁴." Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve përmban një lloj të drejte për iniciativën e fëmijës për veprim në gjykatë në nenin 37.d, ku fëmija mund të kundërshtojë ligjshëmërinë e mohimit të lirisë për të. Aktualisht ka mbështetje të plotë për përcaktimin e procedurës së ankimimit sipas kësaj konvente⁶⁵. Kjo shpresojmë t'u japë fëmijëve të njëjtat mjete për të luftuar shkeljet e të drejtave të tyre siç u jepen dhe të rriturve mbështetur në shumë konventa të tjera universale për të drejtat e njeriut.

91. Në të njëjtën kontekst, KEDNJ-ja i jep "kujtudo" të cilit i janë mohuar të drejtat të drejtën për "një mjet efektiv ligjor përpara një autoriteti kombëtar"⁶⁶. Ky formulim i përfshin qartazi dhe fëmijët. Rezultati është që fëmijët mund t'i çojnë çështjet e tyre përpara Gjykatës, megjithëse shpesh ata nuk kanë të drejtë të hapin procese gjyqësore mbështetur në të drejtën e brendshme.⁶⁷

92. Duke pasur parasysh faktin që legjislacioni për paaftësinë ligjore të fëmijëve është hartuar me këndvështrimin e mbrojtjes së fëmijëve, është megjithatë e

⁶⁴ Rekomandimi 1121 (1990) për të drejtat e fëmijëve, paragrafi 6.

⁶⁵ Fushata për një mekanizëm ankesash për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

⁶⁶ Neni 13.

⁶⁷ Shih raportin e Sekretarisë së Gjykatës, op. cit., f. 5: "Fëmijët mund të aplikojnë në gjykatë edhe kur nuk kanë të drejtë në të drejtën e brendshme që të ngrenë një çështje penale".

domosdoshme që kjo mungesë aftësie të mos përdoret kundër tyre kur atyre u shkelen të drejtat, ose kur askush tjetër nuk i mbron të drejtat e tyre.

93. Udhëzimi 34 rekomandon po ashtu që legjislacioni i shteteve anëtare të lehtësojë, kur është e mundur, aksesin në gjykatë për fëmijët që i kuptojnë mjaftueshmërisht këto të drejta. Ai rekomandon po ashtu përdorimin e mjeteve efektive për t'i mbrojtur këto të drejta pas marrjes së këshillimit të përshtatshëm ligjor.

94. Vëmendje i duhet kushtuar lidhjes së fortë ndërmjet çështjeve të aksesit në drejtësi, këshillimit⁶⁸ të përshtatshëm ligjor dhe të drejtës për të shprehur një opinion në procedurat e gjykatës. Nuk është qëllimi i këtyre udhëzimeve që t'i inkurajojnë fëmijët t'i drejtohen gjykatës pa arsye, ose pa shkak ligjor. Nuk është e nevojshme të thuhet që fëmijët, ashtu siç edhe të rriturit, duhet të kenë një bazë ligjore solide për ta dërguar një çështje në gjykatë. Atëherë kur të drejtat e fëmijëve janë shkelur ose duhet të mbrohen dhe kurdo që përfaqësuesi ligjor nuk e bën mbrojtjen në emër të fëmijës, duhet të ekzistojë mundësia që çështja të rishikohet nga një autoritet gjyqësor. Aksesi i fëmijëve në gjykata mund të jetë po ashtu i nevojshëm në rastet kur mund të ketë një konflikt interesi ndërmjet fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor.

95. Aksesi në gjykatë mund të mbështetet në një kufi të caktuar moshe ose në nocionin e një shkak të caktuar, të pjekurisë ose nivelit të të kuptuarit. Të dyja sistemet kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Një afat i qartë moshe mbart avantazhin e objektivitetit për të gjithë fëmijët dhe garanton sigurinë juridike. Megjithatë, duke ju dhënë akses fëmijëve mbështetur në shqetësimin e tyre individual të jep mundësinë për përshtatje ndaj çdo fëmije të vetëm, sipas nivelit të tyre të pjekurisë. Ky sistem mund të çojë në rreziqe për shkak të pragut të gjerë të vlerësimit që i lihet në dorë gjyqtarit të përfshirë. Një

⁶⁸ Kjo shërben dhe për ta bindur një fëmijë për të mos e filluar një procedurë kur në fakt nuk ka bazë ligjore ose chans për të qenë e suksesshme.

mundësi e tretë është kombinimi i të dyjave: një kufi i caktuar moshe ligjore me mundësinë për një fëmijë nën këtë moshë për ta kundërshtuar kufirin⁶⁹. Megjithatë, kjo mund të çojë në problemin shtesë që barra e provës për zotësinë ose çështjen i mbetet fëmijës.

96. Në këto udhëzime nuk përcaktohen afate kohore, pasi afatet kohore kanë tendencë të jenë shumë strikte dhe arbitrare dhe mund të kenë pasoja vërtetë të padrejta. Po ashtu, ato nuk mund të marrin plotësisht parasysh diversitetin e kapaciteteve dhe të niveleve të të kuptuarit ndërmjet fëmijëve. Këto nivele mund të ndryshojnë shumë në varësi të kapacitetit individual të zhvillimit të fëmijës, eksperiencave jetësore të tyre, aftësive kognitive dhe aftësive të tjera. Një 15-vjeçar mund të jetë më pak i pjekur sesa një 12-vjeçar, ndërsa fëmijët shumë të vegjël mund të jenë mjaftueshmërisht inteligjent për të vlerësuar dhe për të kuptuar situatën e vet specifike. Aftësia, pjekuria dhe niveli i të kuptuarit janë më përfaqësuese të kapaciteteve të vërteta të fëmijës sesa mosha e tij ose e saj.

97. Ndërsa pranojmë që të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha ose aftësitë, janë mbajtës të së drejtave, mosha është në fakt një çështje kyçe në praktikë, pasi fëmijët shumë të vegjël ose fëmijët me disa paaftësi nuk mund të jenë në gjendje të mbrojnë me efektivitet të drejtat e tyre vetë. Për pasojë, shtetet anëtare duhet të krijojnë sistemet ku të rritur të caktuar të jenë në gjendje të veprojnë në emër të fëmijës: ata mund të jenë prindërit, avokatët, ose institucione ose subjekte të tjera, të cilat, sipas të drejtës së brendshme janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këta persona ose institucione jo vetëm që duhet të përfshihen ose të njihen me situatën kur procedurat janë pezull, por duhet edhe të kenë mandatin që të nisin kryesisht një çështje kur shkelen të drejtat e një fëmije, ose kur këto të drejta janë në rrezik shkeljeje.

⁶⁹ Për shembull, legjislacioni belg ndonjëherë përdor kufirin moshe dhe ndonjëherë përdor shkallën e mprehtësisë së fëmijës.

98. Udhëzimi 35 rekomandon që shtetet anëtare të heqin të gjitha pengesat për aksesin e fëmijëve në gjykata. Ai jep shembuj të tillë si kostoja e proceseve gjyqësore dhe mungesa e këshillimit ligjor, por rekomandon dhe heqjen e pengesave të tjera. Këto pengesa mund të jenë të natyrave të ndryshme. Në rast të një konflikti të mundshëm ndërmjet fëmijëve dhe prindërve të tyre duhet të shmanget kërkesa për pëlqimin e prindërve. Duhet të zhvillohet një sistem nëpërmjet të cilit refuzimi i pavend i një prindi nuk mund ta pengojë fëmijën nga pasja akses në drejtësi. Pengesa të tjera për të pasur akses në drejtësi mund të jenë të një natyre financiare ose psikologjike. Kërkesat procedurale duhet të kufizohen sa më shumë të jetë e mundur⁷⁰.

99. Në disa raste fëmijët nuk mund të kundërshtojnë akte ose vendime të caktuara gjatë fëmijërisë për shkak të traumës që pësojnë, për shembull, për shkak të abuzimit seksual ose çështjeve familjare shumë konfliktuale.

100. Në raste të tilla, Udhëzimi 36 rekomandon dhënien e të drejtës për akses në gjykatë për një periudhë kohë pasi fëmija ka arritur moshën madhore. Për pasojë, ky rekomandim i inkurajon shtetet anëtare të rishikojnë periudhat e parashkrimeve. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (CETS nr. 201) mund të shërbejë si frymëzim në këtë aspekt.⁷¹

Në çështjen *Stubbings dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Madhe*⁷² Gjykata u shpreh se “gjatë viteve të fundit është rritur shkalla e ndërjegjësisimit lidhur me gamën e problemeve të shkaktuara nga abuzimi i fëmijëve dhe efektet psikologjike të tyre tek

⁷⁰ Duhet të shmanget qasja shumë e kufizuar ose thjesht teknike për përfaqësimin. Shih I. Berro-Lefevre “Të përmirësojmë aksesin e fëmijëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, Drejtësia Ndërkombëtare për Fëmijët, Monografi Nr. 3, Strasburg, Botimet e Këshillit të Evropës, 2008, f. 69-78.

⁷¹ Neni 33.

⁷² Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma), datë 22 tetor 1996, *Stubbings dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22083/93; 22095/93, paragrafi 56. <http://www.coe.int/t/dghl/>.

viktimat dhe është e mundur që rregullat e kufizimit të veprimeve që zbatohen në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës të mund të duhet të ndryshohen për të pasur një dispozitë të posaçme për këtë grup ankimesish në të ardhmen e afërt⁷³.

2. Avokati dhe përfaqësimi ligjor⁷⁴

101. Nëse fëmijët kanë të drejtë të kenë akses në një drejtësi që është vërtetë miqësore për fëmijët, shtetet anëtare duhet të lehtësojnë aksesin tek avokati ose çdo institucion apo subjekt tjetër i cili, sipas të drejtës së brendshme, është përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të përfaqësohet me emrin e vet kur ka, ose kur mund të ketë një konflikt interesi ndërmjet fëmijës dhe prindërve, ose palëve të tjera të interesuara. Ky është mesazhi kryesor i Udhëzimit 37. Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (ETS nr. 160)⁷⁵ deklaron se: “palët duhet të marrin parasysh që t’i japin fëmijëve të drejta procedurale shtesë lidhur me proceset përpara një autoriteti gjyqësor që i prek ata, në veçanti [...] përfaqësim ligjor të veçantë [...] avokat”⁷⁶.

102. Udhëzimi 38 rekomandon që fëmijëve t’u jepet akses në ndihmën juridike falas. Kjo jo domosdoshmërisht kërkon një sistem tërësisht të veçantë të ndihmës juridike falas për fëmijët. Kjo ndihmë mund të ofrohet në të njëjtën mënyrë si ndihma ligjore për të rriturit, ose mbështetur në kushte më të lehta dhe të varet nga mjetet financiare të mbajtësit të përgjegjësishë prindërore, ose të vetë fëmijës. Në çdo rast, sistemi i ndihmës juridike falas duhet të jetë efektiv në praktikë.

103. Udhëzimi 39 përshkruan kërkesat profesionale për avokatët që përfaqësojnë fëmijët. Është po ashtu e rëndësishme që tarifat ligjore për

⁷³ Paragrafi 56.

⁷⁴ Shih ChildONEurope, Sondazh për sistemet kombëtare të përfaqësimit ligjor të fëmijëve, mars 2008 (www.childoneurope.org). Në këtë sondazh jepen të ilustruara shumë modele.

⁷⁵ ETS nr. 160.

⁷⁶ Neni 5.b.

avokatin e fëmijës të mos i ngarkohen prindërve të fëmijës, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në rast se avokati paguhet nga prindërit, veçanërisht në rastet me interesa konfliktuale, nuk ka garanci që avokati do të ketë mundësi të mbrojë në mënyrë të pavarur pikëpamjet e fëmijës.

104. Rekomandohet sigurimi i një sistemi për avokatë të specializuar për të rinjtë, ndërsa respektohet dëshira e lirë fëmijës për përzgjedhjen e avokatit. Avokatit nuk i duhet të nxjerrë në pah se çfarë mendon ai ose ajo se është në interesin më të mirë të fëmijës (ndryshe nga kujdestari ose mbrojtësi publik), por duhet të përcaktojë dhe të mbrojë pikëpamjet dhe opinionet e fëmijës ashtu si në rastin e një klienti të rritur. Avokati duhet të kërkojë pëlqimin e informuar të fëmijës për strategjinë më të mirë për t'u përdorur prej tij. Në rast se avokati nuk është dakord me opinionin e fëmijës, ai/ajo duhet të përpiqet ta bindë fëmijën ashtu siç do të kishte bërë me çdo klient tjetër.

105. Roli i avokatit është i ndryshëm nga roli i kujdestarit *ad litem*, rol i prezantuar në Udhëzimin 42, pasi ky i fundit caktohet nga gjykata, jo nga “klienti” dhe duhet ta ndihmojë gjykatën të përcaktojë se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijës. Megjithatë, duhet të shmanget kombinimi i funksioneve të një avokati me një kujdestar *ad litem* në një person, për shkak të potencialit të konfliktit të interesave që mund të ngrihet. Në raste të caktuara, organi kompetent duhet të emërojë ose një kujdestar *ad litem* ose një përfaqësues të pavarur për të përfaqësuar pikëpamjet e fëmijës. Kjo mund të bëhet me kërkesë të fëmijës, ose të një pale tjetër përkatëse.

Në Gjeorgji, e drejta për përfaqësim ligjor për personat nën moshën 18 vjeç në çështjet penale jepet *ex officio* (kryesisht), pasi këta persona konsiderohen se janë “vulnerabël në aspektin social”. Nuk kërkohet asnjë kusht tjetër për këta fëmijë për të përfituar nga ky shërbim.

3. E drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet

106. Komenti i përgjithshëm nr. 12 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve interpreton të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar, e cila është një ndër katër parimet kryesore të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve duke përdorur fjalët “duhet të sigurojë”, të cilat përbëjnë një term ligjor me fuqi të posaçme që nuk lënë hapësirë për diskrecion të shteteve palë.⁷⁷ Ky koment shtjellon faktin që vetëm mosha nuk mund të përcaktojë domethënien e pikëpamjeve të një fëmije⁷⁸. Në komentin e përgjithshëm nr. 5, Komiteti vëren me të drejtë që “të dukurit sikur i dëgjon fëmijët është relativisht i pakundërshtueshëm; dhënia e peshës së nevojshme pikëpamjeve të tyre kërkon ndryshim real⁷⁹.”

107. Neni 3 i Konventës Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (ETS nr. 160) e kombinon të drejtën për t'u dëgjuar me të drejtën për t'u informuar: në proceset gjyqësore fëmijët duhet të marrin të gjithë informacionin përkatës, të konsultohen dhe të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të informohen për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.

108. Në këto udhëzime përmenden dhe koncepte të tilla si “mosha dhe pjekuria” dhe “të kuptuarit e mjaftueshëm”, i cili kupton një nivel të caktuar të të kuptuarit, por nuk shkon aq larg sa të kërkojë njohuri të plotë gjithëpërfshirëse të të gjitha aspekteve të çështjes nën shqyrtim⁸⁰ nga fëmija.

⁷⁷ Komenti i përgjithshëm nr. 12 për të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 19.

⁷⁸ Po aty, paragrafi 28-31.

⁷⁹ Komenti i përgjithshëm nr. 5 për masat e përgjithshme zbatuese për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (CRC/GC/2003/5), neni 12.

⁸⁰ Për më shumë informacion shih Analizën CRIN: “Matja e pjekurisë. Të kuptuarit e “zhvillimit të kapaciteteve” tek fëmijët.

Fëmijët kanë të drejtë t'i japin pikëpamjet e tyre lirisht, pa presion dhe pa manipulim⁸¹.

109. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime përdorin formulimin “i ndjeshëm për fëmijët” si “një qasje që balancon të drejtat e fëmijëve për mbrojtje dhe që merr parasysh nevojat dhe pikëpamjet individuale të fëmijëve”⁸².

110. Ligjet duhet të formulohen qartë për të siguruar barazi ligjore për të gjithë fëmijët. Pavarësisht nga mosha, veçanërisht kur fëmija merr iniciativën që të dëgjohet, duhet të prezumohet një nivel i mjaftueshëm i të kuptuarit. Megjithatë, mosha luan ende rol kryesor për t’ju dhënë fëmijëve të drejtën bazë që të dëgjohen për çështjet që i prekin ata (Udhëzimi 45). Gjithsesi, duhet të theksohet se në disa rrethana është detyra e fëmijës që të dëgjohet (pra, të japë prova).

111. Fëmijët duhet të dinë saktësisht se çfarë do të ndodhë dhe se cili do të jetë statusi i opinionëve ose i deklaratave të dhëna prej tyre⁸³. Gjyqtari nuk duhet të refuzojë ta dëgjojë fëmijën pa pasur arsye të forta, në përjashtim të rasteve kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijëve (Udhëzimi 47). Fëmijët duhet të informohen qartë që në rast se një gjyqtar nuk i dëgjon, kjo nuk do të thotë që ata do ta “fitojnë” çështjen. Për të fituar besimin dhe respektin për një vendim të marrë, duhet të bëhen përpjekje të veçanta nga avokati i fëmijës për të shpjeguar se pse nuk është ndjekur opinion i fëmijës, ose pse është marrë vendimi në fjalë, ashtu si edhe në rastin e të rriturve (Udhëzimi 48).

⁸¹ Komenti i përgjithshëm nr. 12 për të drejtat e fëmijëve për t’u dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 22.

⁸² Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështje që përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSO Res 2005/20, 22 korrik 2005)

⁸³ Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Neni 3.c.

112. Më tej, fëmijët kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet dhe opinionin e tyre për çdo çështje ose rast që i përfshin ose ka ndikim mbi ta. Ata duhet të kenë mundësinë ta bëjnë këtë gjë pavarësisht nga mosha, në një mjedis të sigurt dhe që respektues ndaj tyre. Ata duhet të ndihen rehat kur flasin me një gjyqtar ose me zyrtarë të tjerë. Kjo nënkupton që gjyqtarit mund t'i duhet të heqë formalitete të caktuara, të tilla si të vërë paruke dhe të veshë uniformën, ose të dëgjojë fëmijën në sallën e gjyqit. Për shembull, mund të jetë e dobishme që fëmija të dëgjohej në zyrat e gjyqtarëve.
113. Është e rëndësishme që fëmija të flasë lirshëm, pa u ndaluar. Në praktikë, kjo mund të nënkuptojë që në sallë nuk duhet të lejohen persona të tjerë (si për shembull, prindërit ose autori i pretenduar për ngjarjen) dhe që atmosfera të mos priset nga ndërprerje të palejuara, sjellja e padenjë ose hyrja dhe dalja e shpeshtë së njerëzve në sallë.
114. Shpesh gjyqtarët nuk janë të trajnuar për të komunikuar me fëmijët, ndërsa profesionistët e specializuar rrallë thërriten për t'i mbështetur ata në punën e tyre. Siç është theksuar dhe më lart (paragrafi 96), edhe fëmijët mund t'i shprehin qartë pikëpamjet e tyre në qoftë se ndihmohen dhe mbështeten siç duhet. Gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë duhet të kërkojnë për pikëpamjet, opinionet, dhe perspektivën e një fëmije në një çështje të caktuar.
115. Në varësi të dëshirave dhe të interesave të fëmijëve, duhet marrë seriozisht fakti se kush do të dëgjojë atë që do të thotë fëmija, pra gjyqtari, apo një ekspert i caktuar⁸⁴. Disa fëmijë mund të preferojnë që të dëgjohej nga një "ekspert", i cili pasi e ka dëgjuar fëmijën, ia transmeton pikëpamjen e tij gjyqtarit. Megjithatë, ka fëmijë të tjerë të cilët e bëjnë të qartë që duan të dëgjohej nga gjyqtari, pasi gjyqtari është personi që merr vendimet.

⁸⁴ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve rekomandon që fëmijët të dëgjohej në mënyrë të drejtpërdrejtë. Komenti i përgjithshëm nr. 12 për të Drejtën e Fëmijëve për t'u Dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 35.

116. Ndërsa është e vërtetë që ekziston rreziku i manipulimit të fëmijëve kur ata dëgjoen dhe shprehin pikëpamjet e tyre (për shembull, nga një prind kundër prindit tjetër), duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që ky rrezik të mos lihet që ta cenojë këtë të drejtë themelore.

117. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve paralajmëron kundër një qasje simbolike dhe praktikave jo etike⁸⁵ dhe liston kërkesat bazë për zbatim efektiv dhe të kuptimtë të të drejtës për t'u dëgjuar⁸⁶. Proceset për dëgjimin e fëmijëve duhet të jenë transparente dhe informuese, vullnetare, që i respektojnë fëmijët, të përshtatshme, miqësore ndaj fëmijëve, përfshirëse, të realizuara nga staf i trajnuar, të sigurta dhe të ndjeshme ndaj rrezikut dhe, në fund, dhe llogaridhënëse.

Në një çështje të lidhur me një birësim jashtë vendit me birësues Italianë të fëmijëve rumunë (çështja *Pini dhe të Tjerët k. Rumanisë*), Gjykata ishte shumë e qartë lidhur me të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe për marrjen seriozisht të pikëpamjeve të tyre: "Duhet të theksohet se në çështjen në fjalë fëmijët e kundërshtuan idenë e qëndrimit me prindërit birësues në Itali pasi kishin arritur një moshë e cila mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme që lejon një personalitet mjaftueshmërisht të zhvilluar dhe pjekurinë e nevojshme për të shprehur mendimet lidhur me mjedisin ku dëshironin të rriteshin"⁸⁷. "Interesat e fëmijëve diktojnë nevojën e marrjes parasysht të mendimeve të tyre pasi të kenë fituar pjekurinë e nevojshme për shprehjen e këtyre interesave. Refuzimi i vazhdueshëm i fëmijëve për të udhëtuar në Itali dhe për t'u

⁸⁵ Komenti i përgjithshëm nr. 12 për të Drejtën e Fëmijëve për t'u Dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 132: "Komiteti u bën thirrje shteteve palë të shmangin qasjet simbolike të cilat e kufizojnë shprehjen e pikëpamjeve nga fëmijët, ose të cilat i lejojnë fëmijët që të dëgjoen, por nuk u japin peshën e duhur pikëpamjeve të tyre. Ai thekson se manipulimi i fëmijëve nga të rriturit, duke i vendosur fëmijët në situata ku atyre u tregohet se çfarë mund të thonë, ose duke i ekspozuar ndaj rrezikut të dëmtimit nëpërmjet pjesëmarrjes nuk janë praktika etike dhe nuk mund të kuptohen si zbatuese për qëllime të nenit 12".

⁸⁶ Komenti i përgjithshëm nr. 12 për të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar (CRC/C/GC/12, 1 korrik 2009), paragrafi 133-134.

⁸⁷ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), datë 22 qershor 2004, *Pini dhe të Tjerët. k. Rumanisë*, nr. 78028/01 dhe 78030/01, paragrafi 157.

bashkuar me prindërit e tyre birësues pasi ata kishin mbushur moshën 10 vjeç mbart një peshë të caktuar në këtë aspekt⁸⁸.

Në çështjen *Hokkanen k. Finlandës*, një baba kërkonte kujdestarinë e vajzës së tij, ndërkohë që vajza kishte vite që jetonte me gjyshërit e saj. Vajza nuk donte të jetonte me të atin. Në këto rrethana Gjykata ra dakord që “fëmija ishte mjaftueshmërisht e pjekur për t’ju marrë parasysh pikëpamjet dhe, për pasojë, birësimi nuk mund të jepet në kundërshtim me dëshirat e saj”⁸⁹.

4. Shmangia e vonesave të panevojshme

118. Çështjet ku përfshihen fëmijët duhet të trajtohen me shpejtësi. Për këtë arsye mund të shqyrtohet⁹⁰ mundësia e një sistemi që bën përcaktimin e përparësisë së çështjeve. Parimi i urgjencës përcaktohet në Udhëzimin 50. Duhet të mbahet parasysh se fëmijët kanë tjetër perceptim për kohën krahasuar me të rriturit dhe se elementi kohë është shumë i rëndësishëm për ta: për shembull, kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për kujdestarinë për një vit mund të duket periudhë shumë më e gjatë për një 10-vjeçar sesa për një të rritur. Rregullat e gjykatës duhet të lejojnë një sistem që përcakton çështjet e rënda dhe urgjente, ose rastet kur çështja mund të çojë në pasoja të mundshme të patjetërsueshme në rast se nuk merren masa të menjëhershme (Udhëzimi 51 që mbulon çështje të së drejtës familjare).

119. Shembuj të tjerë të këtij parimi mund të gjenden në instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës. Njëri prej tyre kërkon që shtetet të sigurojnë që hetimet dhe proceset penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen pa

⁸⁸ Po aty, paragrafi 164.

⁸⁹ Vendim, datë 23 shtator 1994, *Hokkanen k. Finlandës*, nr. 19823/92, paragrafi 61.

⁹⁰ Cf. neni 41 i Rregullores së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas I. Berro-Lefevre ky nen duhet të përdoret më shpesh; op.cit., f. 76.

vonesa të pajustificuara⁹¹. Ky trajtim është po ashtu shumë e rëndësishme për t'u lejuar fëmijëve të jenë në gjendje të fillojnë procesin e rimëkëmbjes. Një tjetër instrument rekomandon specifikisht "sigurimin e trajtimit më të shpejtë për minorenët, duke shmangur vonesat e panevojshme, në mënyrë që të garantohet veprim efektiv arsimor"⁹².

120. Të respektuarit e interesave më të larta të fëmijës mund të kërkojë fleksibilitet nga ana e organeve gjyqësore, ndërsa zbatohen vendime të caktuara në përputhje me të drejtën e brendshme, siç tregohet në Udhëzimin 53.

Në dy çështje kundër Gjermanisë Gjykata ka diskutuar elementin kohë dhe konstatoi se në rastet e marrëdhënieve prind-fëmijë ekziston detyra e ushtrimit të kujdesit përjashtimor lidhur me faktin që rreziku i kalimit të kohës mund të çojë në përcaktimin *de facto* të çështjes dhe që mund të ndërpresë⁹³ marrëdhënien e fëmijës me njërin nga prindërit e tij.

Në çështjen *Paulsen-Medalen dhe Svesson k. Suedisë* Gjykata gjeti shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i GJED-së pasi autoritetet nuk kishin vepruar me kujdes përjashtimor gjatë trajtimit të një mosmarrëveshjeje për aksesin⁹⁴.

Po ashtu, shmangia e vonesave të panevojshme është e rëndësishme në çështjet penale. Në çështjen *Bouamar k. Belgjikës*, në rastin e ndalimit të fëmijëve Gjykata u shpreh se kërkohet një analizim i shpejtë gjyqësor i çështjes. Kalimi i pajustificuar i

⁹¹ Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (CETS nr. 201. Neni 30, paragrafi 3).

⁹² Rekomandimi nr. R(87)20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për reagimet sociale ndaj kriminalitetit tek të rinjtë, paragrafi 4.

⁹³ Shih Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), datë 13 korrik 2000, *Elsholz k. Gjermanisë*, nr. 25735/94, paragrafi 49, dhe vendimin, datë 8 korrik 2003, *Sommerfeld k. Gjermanisë*, nr. 31871/96, paragrafi 63.

⁹⁴ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma), datë 19 shkurt 1998, *Paulsen-Medalen dhe Svesson k. Suedisë*, nr. 16817/90, paragrafi 42.

kohës zor se mund të konsiderohen në përputhje me shpejtësinë që kërkohet sipas nenit 5, paragrafi 4 i KEDNJ-së⁹⁵.

5. Organizimi i proceseve gjyqësore, mjedisi miqësor ndaj fëmijëve dhe gjuha miqësore ndaj fëmijëve

121. Metodat⁹⁶ e punës miqësore ndaj fëmijës duhet t'u bëjnë të mundur fëmijëve që të ndihen të sigurt. Shoqërimi nga një person të cilit ata i besojnë i bën fëmijët të ndihen më rehat me procesin. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (CETS nr. 201)⁹⁷ parashikon që një fëmijë mund të shoqërohet nga përfaqësuesi i tij/saj ligjor, ose një i rritur i përzgjedhur prej tij/saj, me kusht që personi duhet të konsiderohet si i përshtatshëm. Kundër pranisë së një personi të caktuar shoqërues duhet të merret një vendim i arsyetuar.

122. Mjedisi arkitekturor mund t'i bëjë fëmijët të ndihen shumë jo rehat. Zyrtarët e gjykatës duhet t'i njohin fëmijët, *inter alia*, me organizimin e gjykatës dhe me identitet e zyrtarëve të përfshirë (Udhëzimi 55). Ambientet e gjykatave mund të jenë shtypëse dhe frikësuese edhe për të rriturit (Udhëzimi 62). Ndërsa kjo është e vështirë për t'u ndryshuar, të paktën për godinat ekzistuese të gjykatave, ka mënyra sesi mund të përmirësohet trajtimi i fëmijëve në sallat e gjyqit duke punuar me fëmijët duke qenë më të kujdesshëm me ta.

123. Kur është e mundur, ambientet e gjykatave mund të përfshijnë salla të posaçme intervistimi, të cilat marrin parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Po ashtu, mjedisi miqësor me fëmijën mund të nënkuptojë mosvënien e parukeve ose mosveshjen e pelerinave të rënda pjesë e uniformës së

⁹⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Dhoma), datë 29 shkurt 1988, *Bouamar k. Belgjikës*, nr. 9106/80, paragrafi 63.

⁹⁶ Shih W. McCarney "Parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijës në nivelin ndërkombëtar" *Drejtësia Ndërkombëtare për Fëmijët*, Monografi nr. 3, Botim i Këshillit të Evropës, 2008, f. 119-127.

⁹⁷ Neni 35.1.f.

gjqtarëve, ose mosveshjen e veshjeve që janë pjesë e uniformave të tjera të përdorura prej tyre. Këto veprime mund të bëhen duke pasur parasysh moshën e fëmijës, ose funksionin e zyrtarit. Në varësi të rrethanave dhe të pikëpamjeve të fëmijës, mund të ndodhë që, për shembull, uniformat t'ia bëjnë të qartë fëmijës që ai po flet me një oficer policie dhe jo me një punonjës social, gjë që ka rëndësinë e vet. Kjo mund të përforcojë ndjesinë e fëmijës që çështjet që e prekin atë merren seriozisht nga organet përgjegjëse. Në përmbledhje, ambientet mund të jenë relativisht formale, por sjellja e zyrtarëve duhet të jetë më pak formale dhe, në çdo rast, duhet të jetë miqësore ndaj fëmijës.

124. Ajo çfarë është më e rëndësishme është që drejtësia miqësore ndaj fëmijës të nënkuptojë që fëmijët e kuptojnë natyrën dhe objektin e vendimeve të marra dhe të efekteve të tyre. Ndërkohë që vendimet dhe arsyetimet jo gjithmonë mund të regjistrohen dhe të shpjegohen me një formulim miqësor ndaj fëmijës për shkak të kërkesave ligjore, fëmijëve duhet t'u shpjegohen këto vendime ose nga avokati, ose nga një person tjetër i përshtatshëm (prindi, punonjësi social, etj.).

125. Për veprat e kryera nga fëmijët⁹⁸ mund të krijohen gjykata specifike për të rinjtë. Për aq sa është e mundur nuk duhet të lejohet⁹⁹ asnjë referim i fëmijëve në gjykatat për të rriturit, në procedurat për të rriturit ose në dënimet për të rriturit. Në përputhje me kërkesën për specializim në këtë fushë, brenda autoriteteve ligjzbatuese mund të krijohen njësi të specializuara (Udhëzimi 63) të posaçme për fëmijët.

Në shumë çështje kundër Mbretërisë së Madhe që përfshijnë fëmijë si autorë krimesh, Gjykata ka theksuar se duhen marrë masa të posaçme për të modifikuar procedurën për të rriturit nga gjykatat për të zbutur aspektet strikte të një gjykimi kundër një të

⁹⁸ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 40.3.

⁹⁹ Rekomandimi nr R(87) 20 i Këshillit të Evropës për reagimet sociale për kriminalitetin tek të rinjtë, proceset kundër minorenëve, paragrafi 5.

rrituri nga këndvështrimi i moshës së re të fëmijës. Për shembull, profesionistët ligjorë nuk duhet të mbajnë paruke dhe pelerina dhe fëmijët nuk duhet të ulen në një vend të veçante më të ngritur në sallë, por duhet të ulen ngjitur me përfaqësuesin ligjor ose me punonjësin social. Seancat duhet të drejtohen në mënyrë të tillë që ndjenjat e frikës dhe të ndalimit të ulen sa më shumë të jetë e mundur për fëmijët.

Pas çështjeve *T k. Mbretërisë së Madhe* dhe *V. k. Mbretërisë së Madhe* ku organizimet e brendshme të gjykatave kombëtare u konsideruan se ishin frikësuese për një fëmijë, u hartua një Drejtim Praktike për Gjykimin e Fëmijëve dhe të Rinjve në Gjykatat e Mbretërisë. Qëllimi ishte shmangia e frikës, marrjes nëpër këmbë dhe ankthit për fëmijët nën gjykim. Elementë të këtij drejtimi praktike janë, *inter alia*: mundësia e fëmijës për të vizituar sallën e gjyqit përpara fillimit të gjyqimit për t'u njohur me të, mundësia e mbështetjes së policisë për të shmangur kërcënimin ose abuzimin nga shtypi, mosvënia e parukes ose mosveshja e pelerinave, shpjegimi i procedurës në mënyrë të tillë që të kuptohet nga fëmija, pjesëmarrje e kufizuar në seancat dëgjimore të gjykatës, etj.

Ministria e Drejtësisë e Polonisë promovon dhe zbaton konceptin e dhomave të intervistimit miqësore ndaj fëmijëve në bashkëpunim me një OJQ. Qëllimi kryesor është mbrojtja e fëmijëve dëshmitarë dhe viktima, veçanërisht lidhur me krimet që përfshijnë dhunë seksuale dhe dhunë në familje, duke vënë në praktikë nga stafi përgjegjës parimet e intervistimit të fëmijëve në kushte miqësore ndaj fëmijëve. Procedura siguron intervistimin e fëmijëve nga një gjyqtar në praninë e një psikologu. Personat e tjerë të përfshirë (prokurori, avokati, i akuzuari, ankimmuesi privat) janë të pranishëm në një dhomë tjetër dhe kanë mundësinë e pjesëmarrjes në intervistë falë sistemeve të komunikimit ndërmjet sallave, parjes nëpërmjet xhamave ku mund të shihet vetëm nga njëra anë dhe/ose transmetimit direkt. Detaje të rëndësishme për t'i bërë fëmijët të ndihen më rehat përfshijnë, *inter alia*: garantimin e privacisë (dye që nuk lejojnë përçimin e tingujve ndërmjet dhomës së intervistimit dhe dhomave/ambienteve të tjera); dhoma të pajisura në përputhje me nevojat e fëmijëve për të siguruar sigurinë fizike dhe mendore të fëmijës gjatë intervistimit, përdorimin e ngjyrave dhe orendive neutrale në salla, të cilat sigurojnë që fëmijët mund të

harxhojnë kohë rehat (tavolina dhe karrige me dy përmasa, një divan ose kolltuk, tapet të butë); salla të pajisura me materiale dhe objekte të tjera të dobishme për mbledhjen e informacionit nga një fëmijë (lapsa me ngjyra, letër, kukulla, etj.).

6. Provat/dëshmitë e dhëna nga fëmijët

126. Çështja e mbledhjes së provave/dëshmimeve nga fëmijët nuk është fare e thjeshtë. Për shkak të standardeve të pakta në këtë fushë (të tilla si Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime)¹⁰⁰, është ndjerë nevoja e trajtimit të çështjeve të tilla, pasi realizimi i intervistimit për të marrë prova/dëshmi kërkon udhëzime praktike.
127. Siç parashikohet në Udhëzimin 64, për aq sa është e mundur intervistimi duhet të kryhet nga profesionistë të trajnuar. Në të njëjtin kuadër, Udhëzimi 66 rekomandon që kur nevojitet më shumë sesa një intervistë, intervistat duhet të realizohen mundësisht nga i njëjti person për arsye të vijimësisë dhe besimit të ndërsjellë, por numri i intervistave duhet të jetë sa më i kufizuar të jetë e mundur (Udhëzimi 67).
128. Për arsye të dukshme duhet të bëhen organizime specifike për mbledhjen e provave, veçanërisht për fëmijët viktima, në kushtet më të favorshme të mundshme. Lejimi i dhënies së dëshmimeve nëpërmjet lidhjeve audio, video dhe televizive janë disa nga shembujt e këtyre praktikave, ashtu

¹⁰⁰ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë që Përfshin Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime (ECOSOC Res 2005/20, 22 korrik 2005), paragrafi XI, 30, d.: “Përdorni procedura të ndjeshme ndaj fëmijëve, përfshirë dhomat e intervistimit të projektuara për fëmijët, shërbime ndërdisiplinore për fëmijët viktima të integruara në një vend, mjedise të modifikuara të gjykatës që marrin parasysh fëmijët dëshmitarë, ndërprerjet gjatë deklarimit të fëmijëve, séanca të programuara në periudha të tilla gjatë ditës që janë të përshtatshme për moshën dhe për pjekurinë e fëmijës, një sistem të përshtatshëm njoftimi për t’u siguruar që fëmija shkon në gjykatë vetëm kur është e nevojshme, si dhe masa për të lehtësuar dëshminë e fëmijës”. Duhet të mbahet parasysh se këto udhëzime kanë të bëjnë me dhënien e dëshmimeve në përgjithësi, dhe nuk lidhen vetëm me proceset penale.

sikurse dhe dhënia e dëshmive të fëmijëve për ekspertët përpara se ato të jepen në seancë dhe shmangia e kontaktit viziv ose e ndonjë kontakti tjetër ndërmjet fëmijës viktimë dhe personit të dyshuar për krimin (Udhëzimi 68), ose dhënia e provave pa praninë e personit të dyshuar për krimin (Udhëzimi 69). Megjithatë, në raste specifike, të tilla si shfrytëzimi seksual, regjistrimi në video i intervistimit mund të jetë traumatik për viktimat. Për pasojë, dëmtimi i mundshëm ose viktimizimi dytësor që vjen nga këto regjistrime duhet të vlerësohet me kujdes, si dhe duhet të shqyrtohen metoda të tjera, të tilla si regjistrimi audio, për të shmangur riviktimizimin dhe traumat e tjera.

129. E drejta dhe legjislacioni procedural i shteteve anëtare në këtë fushë ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe mund të ketë rregulla më pak strikte për dhënien e provave nga fëmijët. Në çdo rast, shtetet anëtare duhet t'i japin përparësi interesave më të mira të fëmijës gjatë zbatimit të legjislacionit lidhur me provat. Shembujt e dhëna në Udhëzimin 70 përfshijnë mungesën e kërkesës për bërjen e betimit ose të deklaratave të tjera të ngjashme për fëmijët. Këto udhëzime nuk kanë për qëllim të prekin garancitë e së drejtës për mbrojtje ligjore në sisteme të ndryshme ligjore; megjithatë, ato i ftojnë shtetet anëtare të përshtatin, kurdo që është e mundur, disa elementë të rregullave për provat në mënyrë që të shmanget traumatizimi shtesë i fëmijëve. Në fund, është gjithnjë gjyqtari ai që shqyrton seriozitetin dhe vlefshmërinë e dëshmive dhe të provave të dhëna.

130. Udhëzimi 70 thekson po ashtu se këto përshtatje për fëmijët në vetvete nuk duhet ta humbin vlerën e dëshmisë së dhënë. Megjithatë, përgatitja e një fëmije dëshmitar për të dhënë dëshmi duhet të shmanget për shkak të rrezikimit të ndikimit të tepruar mbi fëmijën. Përcaktimi i protokolleve model të intervistimit (Udhëzimi 71) nuk duhet të jetë domosdoshmërisht detyrë e gjyqtarëve, por më shumë e autoriteteve kombëtare gjyqësore.

131. Megjithëse përdorimi i regjistrimeve audio ose video të deklaratave të fëmijëve ka disa avantazhe, pasi ato shërbejnë për shmangien e përsëritjes së

eksperiencave shpesh traumatike, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje përpara një gjyqtari hetues mund të jetë më e përshtatshme për fëmijët që nuk janë viktimë, por që mendohet që janë autorë krimesh.

132. Siç u tregua më sipër, mosha nuk duhet të jetë pengesë për të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë plotësisht në procesin gjyqësor¹⁰¹. Dëshmitë e tyre nuk duhet të prezumohen të pavlefshme ose jo të besueshme vetëm për shkak të moshës, sipas Udhëzimit 73.

133. Në rastet kur fëmijët pyeten, ose shprehin dëshirën për të dhënë prova në çështje familjare, i duhet kushtuar rëndësi pozicionit të tyre vulnerabël në familjen përkatëse dhe efektit që mund të japë kjo dëshmi në marrëdhëniet aktuale dhe të ardhshme të fëmijës. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për t'u siguruar që fëmija bëhet i ndërgjegjshëm për pasojat e dëshmisë dhe për të siguruar mbështetje për fëmijët për dhënien e provave nëpërmjet çdonjërit nga mjeteve të përmendura më sipër.

Gjykata i ka pranuar tiparet specifike të proceseve lidhur me veprat seksuale. Në çështjen *S. N. k. Suedisë*, Gjykata konstatoi se: “procese të tilla shpesh konsiderohen si sprovë e rëndë nga viktimë, në veçanti kur kjo e fundit nuk ka dëshirë të përballet me të akuzuarin. Këto tipare janë dhe më të dukshme në çështjet e lidhura me të miturit. Në vlerësimin e pyetjes nëse një i akuzuar në procese të tilla ka qenë objekt i një procesi të rregullt ligjor apo jo, i duhet kushtuar rëndësi edhe të drejtës për respektimin e jetës private të viktimës së pretenduar. Për pasojë, Gjykata e pranon që në çështjet penale të lidhura me abuzimin seksual mund të merren masa të caktuara për qëllimin e mbrojtjes së viktimave, me kusht që këto masa të përkojnë me një ushtrim të përshtatshëm dhe efektiv të të drejtave të mbrojtjes”¹⁰².

¹⁰¹ Po aty, paragrafi VI, 18.

¹⁰² Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), datë 2 korrik 2002, *S. N. k. Suedisë*, nr. 34209/96, paragrafi 47.

Në të njëjtën çështje, vëmendje iu dha dhe natyrës mundësisht orientuese të disa pyetjeve. Për të shmangur efektin negativ, në proces mund të thërriten për të dhënë ndihmë ekspertët e psikologjisë që kanë trajnimin dhe eksperiencën e duhur.¹⁰³

Në çështjen *W. S. k. Polonisë*, Gjykata sugjeroi rrugët e mundshme për të testuar besueshmërinë e një fëmije viktimë dhe theksoi se kjo mund të bëhej në një mënyrë më pak ndërhyrëse sesa nëpërmjet marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Mund të aplikohen metoda të ndryshme të sofistikuara, të tilla si intervistimi i fëmijës në praninë e një psikologu, me pyetjet e parashtruara me shkrim nga mbrojtja, ose në një studio duke i bërë të mundur aplikantit ose avokatit të tij të jetë i pranishëm në këtë intervistim, nëpërmjet lidhjes me video ose ndjekjes së séancës nëpërmjet një xhami që lejon shikimin vetëm nga njëra anë¹⁰⁴.

E. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore

134. Ekzistojnë masa të shumta për ta bërë drejtësinë më miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore. Drejtësia miqësore ndaj fëmijëve pas proceseve gjyqësore fillon me komunikimin dhe shpjegimin e vendimit përkatës të gjykatës për fëmijën (Udhëzimi 75). Ky informacion duhet të plotësohet me një shpjegim të masave që mund të merren, përfshirë dhe apelimin ose përdorimin e një mekanizmi të pavarur ankimi. Kjo punë duhet të realizohet nga përfaqësuesi i fëmijës, pra nga avokati, kujdestari *ad litem* ose nga përfaqësuesi ligjor, në varësi të sistemit ligjor. Udhëzimet 75, 77 dhe 81 flasin për këta përfaqësues.

135. Udhëzimi 76 rekomandon marrjen e hapave pa vonesë për të lehtësuar ekzekutimin e vendimeve që përfshijnë dhe prekin fëmijët.

¹⁰³ Po aty, paragrafi 53.

¹⁰⁴ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), datë 19 qershor 2007, *W. S. k. Polonisë*, paragrafi 61.

136. Në shumë çështje, në veçanti në çështjet penale, vendimi nuk do të thotë domosdoshmërisht që është zgjidhur përfundimisht konflikti ose problemi: çështjet familjare janë shembull i mirë dhe trajtohen nga Udhëzimi 78 dhe Udhëzimi 79. Në këtë fushë të ndjeshme duhet të ketë rregulla të qarta për shmangien e forcës, shtrëngesës dhe dhunës në zbatimin e vendimeve, të tilla si, takimet për vizitat, për të shmangur traumatizime të mëtejshme. Për pasojë, prindërit duhet t'i drejtohen më mirë shërbimeve ndërmjetësuese, ose qendrave neutrale të vizitave për të përfunduar mosmarrëveshjet në vend që të kërkojnë zbatimin e vendimeve të gjykatës nga policia. I vetmi përjashtim është rasti kur ka rrezik për mirëqenien e fëmijës. Rol luajnë dhe shërbime të tjera për ndjekjen e konflikteve familjare, të tilla si shërbimet për mbështetjen e familjeve, për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës.

Në rastet e zbatimit të vendimeve për çështje të së drejtës familjare, të tilla si të drejtat e aksesit në kujdestari ose të drejtat e kujdestarisë, Gjykata është shprehur në shumë raste se ajo çfarë është vendimtare është çështja nëse autoritetet kombëtare i kanë marrë të gjitha hapat e nevojshme për të lehtësuar ekzekutimin siç mund të kërkohe në mënyrë të arsyeshme në rrethanat e posaçme të secilës çështje.

Në Austri, “*Besuchsafe*” u ofron fëmijëve mundësinë të qëndrojnë në kontakt me të dy prindërit pas divorcit ose ndarje në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. E drejta e aksesit mund të ofrohet në ambiente të posaçme nën mbikëqyrjen e stafit të trajnuar për të shmangur konfliktet ndërmjet të dy prindërve kurdo që ushtrohet e drejta për të vizituar fëmijën. Kjo lloj vizite e shoqëruar mund të urdhërohet nga gjykata, ose të kërkohe nga njëri nga të dy prindërit. Çështja qendrore është mirëqenia e fëmijës dhe shmangia e një situate kur fëmija kapet në mes të një konflikti ndërmjet prindërish.

137. Udhëzimet 82 dhe 83 merren me fëmijët në konflikt me të drejtën. Vëmendje e posaçme i kushtohet riintegrit të suksesshëm në shoqëri, rëndësisë së mosbërjes publike të dosjeve penale jashtë sistemit të drejtësisë, dhe pritshmërive legjitime për këtë parim të rëndësishëm. Përjashtim mund të bëhet për krimet e rënda, *inter alia*, për arsye të sigurisë publike dhe, kur bëhet

fjalë për punësimin e njerëzve që merren me fëmijët, për shembull, në rast se një person ka historik të kryerjes së abuzimeve me fëmijët. Udhëzimi 83 ka për synim të mbrojë të gjitha kategoritë e fëmijëve, jo vetëm të fëmijëve vulnerabël.

138. Në çështjes *Bouamar k. Belgjikës*, Gjykata analizoi çështjen e një minoreni autor veprë i cili ishte futur dhe ishte nxjerrë nga një burg për të rritur nëntë herë. Megjithëse ndalimi i minorenëve në burgjet për të rriturit asokohe lejohej mbështetur në ligjin për mbrojtjen e të rinjve, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti në përfundimin se: “nëntë urdhrat e ndalimit, të marra së bashku, nuk ishin në përputhje me nënpikën d të nenit 5.1, veçanërisht përderisa kundër aplikantit nuk ishin çelur asnjëherë procese penale lidhur me veprat e pretenduara se ishin kryer prej tij.”¹⁰⁵

Fondacioni britanik *Bernardo's* ka hapur Shërbimin Këshillimor për Fëmijët në shumë institucione për vuajtjen e dënimit për të rinjtë autorë krimesh në të gjithë Mbretërinë e Madhe duke u dhënë atyre këshillim të pavarur, si dhe duke u ardhur në ndihmë për çështje që lidhen me mirëqenien, kujdesin, trajtimin dhe planifikimin pas daljes nga institucioni ndërkohë që fëmijët janë të ndaluar. Përveç takimeve ballë për ballë brenda një jave nga momenti i burgimit, të rinjtë mund të kontaktojnë me shërbimin ose mund të mbështeten tek shërbimi pa pagesë. Shërbimi këshillimor i ndihmon të rinjtë ta kuptojnë sistemin dhe të kontaktojnë me profesionistët përkatës për t'i ndihmuar për të zgjidhur problemet e tyre.

V. Promovimi i veprimeve të tjera miqësore ndaj fëmijëve

139. Kuptohet pa u thënë që përmirësimi i vërtetë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe në drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve kërkon një qasje aktive

¹⁰⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 29 shkurt 1998, *Bouamar k. Belgjikës*, nr. 9106/80, paragrafët 52-52.

nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat inkurajohen të realizojnë masa të ndryshme.

140. Nënplikat nga *a* në *d* inkurajojnë kërkimet në këtë fushë, shkëmbimin e praktikave, aktivitetet bashkëpunuese dhe ndërgjegjësuese në veçanti duke krijuar versione miqësore të instrumenteve ligjore për fëmijët. Ato shprehin po ashtu mbështetjen për zyra mirëfunktionale informacioni për të drejtat e fëmijëve.

141. Investimi tek edukimi për të drejtat e fëmijëve dhe shpërndarja e informacionit mbi të drejtat e fëmijëve nuk është vetëm detyrim që rrjedh nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve¹⁰⁶, por është po ashtu dhe masë parandaluese kundër shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Të njohësh të drejtat është parakushti i parë për t'i "ushtruar" të drejtat dhe për të qenë në gjendje të identifikosh shkeljet reale ose të shkeljet potenciale të tyre.¹⁰⁷

Shumë organizata kanë prodhuar versione të thjeshtësuara për fëmijët të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe të dokumenteve të tjera përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Një shembull është versioni miqësor për fëmijët i Konventës së Kombeve të Bashkuara në Çështjet që Përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë në Krime nga UNICEF-i dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin.

142. Masat e parashikuara nga nënpika *e* deri tek nënpika *g* kanë për synim të lehtësojnë aksesin e fëmijëve tek gjykatat dhe mekanizmat e ankimimit dhe të shqyrtojnë disa masa të mundshme në këtë aspekt (përcaktimin e gjyqtarëve dhe të juristëve të specializuar, lehtësimin e rolit të shoqërisë civile dhe të organeve të pavarura në nivelin kombëtar, rajonal dhe universal). Në

¹⁰⁶ Neni 42: "Shtetet palë zotohen t'i bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e Konventës si tek të rriturit dhe tek fëmijët nëpërmjet mjeteve të duhura dhe aktive."

¹⁰⁷ Shih po ashtu Barro-Lefevre, op.cit., f. 74-74.

këtë fushë, shtetet duhet të parashikojnë përdorimin e ankesave kolektive. Një shembull i mirë i mekanizmit kolektiv të ankimimit nga Karta Sociale Evropiane, e rishikuar, (ETS nr. 163) është që ai të jetë i pranishëm, nuk nevojitet një viktimë specifike dhe nuk duhet të shterohen të gjitha mjetet e brendshme efektive. Avokatët e popullit për fëmijët, OJQ-të për të drejtat e fëmijëve, shërbimet sociale, etj. duhet të jenë në gjendje të bëjnë ankesa ose të fillojnë procedurat në emër të një fëmije specifike.

143. Është me vlerë të theksohet se strategjitë e reja promovohen dhe në nivelin ndërkombëtar, të tilla si fushata e përmendur më sipër në favor të procedurës së ankimimit mbështetur në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

144. Nën-pika *h* deri në nën-pikën *i* e përqendrojnë vëmendjen tek nevoja për masat e nevojshme arsimore, trajnuese dhe ndërgjegjësuese, ndërsa nën-pika *j* deri tek nën-pika *k* shprehin mbështetje për struktura dhe shërbime të përshtatshme të specializuara.

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

145. Shtetet anëtare inkurajohen të realizojnë disa masa për t'i zbatuar këto udhëzime. Ata duhet të sigurojnë shpërndarjen e gjerë të tyre ndërmjet të gjitha autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ose të përfshira me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Një mundësi është shpërndarja e udhëzimeve në versionet miqësore për fëmijët.

146. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë po ashtu rishikimin e legjislacionit të brendshëm, të politikave dhe të praktikës për t'i respektuar këto udhëzime, si dhe një rishikim periodik të metodave të punës në këtë fushë. Ato ftohen po ashtu të parashikojnë masa specifike për të respektuar frymën dhe shpirtin e këtyre udhëzimeve.

147. Në këtë kuadër, ruajtja ose krijimi i një kuadri, duke përfshirë një ose më shumë mekanizma të pavarur (të tillë si avokatët e popullit, ose avokatët e popullit për fëmijët) ka rëndësi të jashtëzakonshme për promovimin dhe monitorimin e zbatimit të këtyre udhëzimeve.

148. Së fundmi, është e qartë që organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe organeve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet t'u jepet një rol aktiv në procesin e monitorimit.

Udhëzimet për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve dhe memorandumit shpjegues janë miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2010. Mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe evropiane ekzistuese, në veçanti në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, udhëzimet janë projektuar për të garantuar aksesin efektiv në drejtësi dhe trajtimin e përshtatshëm të fëmijëve nga drejtësia. Ato zbatohen mbi të gjitha rrethanat në të cilat fëmijët kanë të ngjarë të hyjnë në kontakt me sistemin e drejtësisë penale, civile ose administrative pavarësisht nga rrethanat dhe kapaciteti i tyre. Ato bëjnë thirrje për respektimin e interesit më të mirë të fëmijëve dhe promovojnë parimet e interesit më të mirë të fëmijëve, për kujdes dhe respekt, pjesëmarrje, trajtim të barabartë dhe sundimin e ligjit. Udhëzimet trajtojnë çështje të tilla si e drejta për informim, përfaqësim dhe pjesëmarrje, mbrojtja e privacisë, sigurisë, qasje multidisiplinore dhe trajnim, siguri në të gjitha fazat e proceseve dhe në rastet e mohimit të lirisë.

Të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës inkurajohen të përshtatin sistemet e tyre juridike me nevojat specifike të fëmijëve duke e mbushur hendekun ndërmjet parimeve ndërkombëtare dhe realitetit. Për këtë arsye, memorandumit shpjegues ofron shembuj të praktikave të mira dhe propozon shembuj për të trajtuar dhe për të mbushur mangësitë ligjore dhe praktike në fushën e drejtësisë për fëmijët.

Këto udhëzime janë pjesë përbërëse e strategjisë së Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të tij “Të ndërtojmë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët”. Në shtetet anëtare janë parashikuar një sërë aktivitete për promovimin, bashkëpunimin dhe monitorimin për të siguruar zbatimin efektiv të udhëzimeve në përfitim të të gjithë fëmijëve.

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar praktikisht të gjithë kontinentin e Evropës. Ai synon të zhvillojë parime të përbashkëta demokratike dhe ligjore mbështetur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në tekste të tjera reference për mbrojtjen e individëve. Që prej themelimit të tij në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar pajtimin.